



AGRON MEXHUANI

HISTORIA 7

Për klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët

LIBRI I MËSIMDHËNËSIT/ES

HISTORIA

7

I. QYTETËRIMI MESJETAR SHEK. V-XV

1. PERIUDHA E MESJETËS-LINDJA E SHOQËRISË FEUDALE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH: Kompetenca I 2; 4. III 5.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Analizon rolin e kishës në shoqërinë mesjetare, identifikon disa nga urdhërat kryesore fetare dhe përshkruan inkuizicionin si mënyrë e luftimit të oponencës ndaj saj.
- Shpjegon veçoritë kryesore të feudalizmit dhe arsyet e lindjes së shtresave të reja shoqërore.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Histori, shkencë, shoqëria njerëzore, periudha historike.

Burimet: Libri, foto

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja fillimisht nxënësve u bënë pyetjet të cilat do të jenë nxitëse dhe orientuese për atë se çfarë do të mësohet. Pyetja duhet të shtrohet në formën që nxënësit të mos kufizohen në përgjigje. Pyetjet mund të jenë: Çfarë ju kujtohet nga vitet e kaluara si ndahen periudhat historike? Cilat janë burimet në të cilat bazohet historia? Çfarë mendoni a ndahet periudha e mesjetës në nënperiudha etj. Të gjitha idetë e nxënësve, mësimdhënësi i liston në tabelë dhe kërkon njëkohësisht që edhe nxënësit t'i shënojnë në fletoret e tyre.

Pjesa kryesore

Në vijim do të kërkohet nga nxënësit të lexojnë në mënyrë individuale, njësinë e ndarë në pjesë, e cila mund të shfrytëzohet pa u ngarkuar me informacione të tepërta. Pas leximit të pjesës, nxënësit do të bashkëbisedojnë në çifte, e më pas së bashku me tërë klasën do të reflektojnë për atë çfarë kanë nxënë.

Pasi të reflektojnë mësimdhënësi mund të parashtrojë pyetje si ndahej periudha e mesjetës. P.sh.Pse mesjeta njihet edhe si "Epoka e Errët"? Sa ka zgatur mesjeta? Pse themi se periudha mesjetare përfundon me „Rilindjen Evropiane”? Cili u bë institucioni më i fuqishëm i periudhës mesjetare? Cili ishte burimi i pasurisë gjatë mesjetës? E kështu me radhë deri sa të përfundojë njësia mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë do të kërkohet nga nxënësit të reflektojnë në mënyrë individuale në fletoret e tyre duke shkruar një “shkrim të lirë” rreth njësisë mësimore p.sh.: Tregoni dallimin në mes shoqërisë skllavopronare dhe asaj feudale? Pasi të përfundojnë, kërkohet nga të gjithë të reflektojnë atë se çfarë kanë zënë gjatë kësaj ore mësimore. Mësimdhënësi duhet të shënojë disa nga idetë e nxënësve në tabelë pasi e gjithë kjo ndihmon në të nxënit në bashkëpunim.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit do të diskutojnë për mjetet e punës, armët etj. që janë përdorur gjatë shoqërisë mesjetare, e më pas do të prezantojnë përmes vizatimeve të bëra.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vëzhgohen gjatë bashkëpunimit njëri me tjetrin.

Nxënësit do të vlerësohen për aktivizimin gjatë punës në grup.

Do të vlerësohen për aftësinë e prezantimit të detyrave të dhëna si në grup, ashtu edhe individuale.

2. JETA E PËRDITSHME E NJERËZVE NË MESJETËN E HERSHME

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimit, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

3.2 Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.

RNSH:Kompetenca II 3; 6. II 7.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Ilustron aspekte të jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Vendbanimet, shtëpitë, veshjet, ushqimi.

Burimet: Libri, foto, hulumtime në internet

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, arti pamor, biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja e fillon bashkëbisedimin me nxënësit në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve me nxënësit. Nxënësit udhëzohen të shkruajnë në mënyrë individuale, për mënyrën e jetesës, veshmbathjet, për profesionet që mund të kenë pasur apo vetë nxënësit që kanë njohuri, nivelin shoqëror, etj. Nxënësit shkruajnë lirshëm, pa kufizime, bashkëbisedojnë në çifte, grup e më pas prezantojnë para klasës.

Pjesa kryesore:

Gjatë kësaj faze të orës nxënësit udhëzohen të lexojnë në mënyrë individuale. Më pastaj kanë për detyrë të përzgjedhin një pjesë të njësisë mësimore, të marrin shënime, të formulojnë pyetje për shokun, të komentojnë në dyshe e më pastaj në grup. Pasi të përfundojnë mund të ketë edhe diskutime. Kjo fazë e orës mësimore realizohet përmes teknikës mendo, puno në çifte, thuaja grupit.

Pjesa përfundimtare:

Pasi të kenë përfunduar, mësimdhënësi/ja, kërkon nga nxënësit që të paraqesin përmes vizatimit, komentit, pjesëzën e mësuar. Pasi të kenë vizatuar, fletët e tyre mund të bëhen në formë të posterit dhe të vihen në mure të klasës.

Aktivitete shitesë:

Vizitë në muzeun etnografik të qytetit.

Përmes këtij aktiviteti, nxitet interesimi i nxënësve për burimet arkeologjike, për kulturën iliro-arbrore, që ata të vazhdojnë të interesohen për zhvillimet e shoqërisë.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vëzhgohen gjatë bashkëpunimit njëri me tjetrin

Nxënësit do të vlerësohen për aktivizimin gjatë punës në grup

Do të vlerësohen për aftësinë e prezantimit të detyrave të dhëna si në grup, ashtu edhe individuale.

3. FAMILJA NË PERIUDHËN E MESJETËS SË HERSHME

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimet, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.

RNSH: Kompetenca I 2. II 1; 7.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Ilustron aspekte të jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Familja, martesë, zot shtëpie.

Burimet: Libri, foto, hulumtime në internet

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Pjesa hyrëse e orës mësimore do të zhvillohet përmes teknikës “Stuhi mendimesh”.

Mësimdhënësi do të parashtrij pyetje rreth njohurive paraprake që mund të kenë fëmijët rreth temës e cila do të zhvillohet gjatë orës mësimore si: Në çfarë kushte jetonin familja në mesjetë? Pse jetonin në familje? Cili ishte roli i gruas në atë kohë? A keni dëgjuar për lidhjen martesore, cilat ishin traditat te popujt e ndryshëm? etj. Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë me ndihmën e mësimdhënësit; Për të krijuar respekt ndaj fëmijëve, për të treguar se janë të vlerësuar, për të krijuar vetëbesim tek nxënësit, për të qenë përgjegjës për fjalën e thënë, për të motivuar dhe inkurajuar për mësim, bashkëpunim dhe komunikim.

Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi paraprakisht ka njësinë mësimore të ndarë në katër pjesë të cilat do t'ua caktojë nxënësve ta mësojnë. Por, fillimisht i ndanë nxënësit në grupe familjare, të cilat do të caktohen

me numra nga 1 deri në 4. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër, treshet me treshë, e kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja. Të gjithë këta nxënës të caktuar në grupet e tyre në bashkëpunim mësojnë njësinë sa më mirë që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'u shpjegojnë nxënësve të tjerë pjesëzën e mësuar. Për të kuptuar sa më mirë pjesën e njësisë mësimore nxënësit parashtrojnë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon deri sa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Pasi të përfundojnë me mësimnxënie, nxënësit shkruajnë një përmbledhje të shkurtë për atë se çfarë kanë mësuar – ese reflektuese. Më pas, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit e ndarë në grupe të reflektojnë para tërë klasës për atë se çfarë kanë mësuar, por gjithnjë duke pasur kujdes që nxënësit të marrin përgjegjësinë për mësimnxënie të pavarur.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit e klasës të ndahen në katër grupe. Secili grup ka për detyrë të emërojë si udhëheqëse të grupit një vajzë. Udhëheqëset e grupit (vajzat), i caktojnë secilit grup detyra të ndryshme të cilat kontribuojnë në rregullat e shkollës.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësve për interesin që shprehin në aktivitete të ndryshme;

Vlerësim i nxënësve në përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin.

Vlerësim formativ.

4. DYNDJET E POPUJVE NË EVROPË

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimet, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

RNSH:Kompetenca I 3; 4. II 8. IV 4.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon disa nga shkaqet e dyndjeve të popujve, rrjedhojat e ngulitjeve të tyre në Evropë dhe identifikon formacionet e reja shtetërore.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Dyndje, barbar, fise, vandal, gotët, hunët, frankët, saksonët

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Gjeografi, arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Kjo fazë e mësimet zhvillohet në formë të pyetjeve dhe të përgjigjeve me nxënësit. Mësimdhënësi/ja i nxit nxënësit që të përgjigjen në mënyrë individuale, duke i dhënë të drejtë të gjithë nxënësve që të debatojnë për pyetjet që ia parashtron mësimdhënësi/ja në raport me njësinë mësimore. Mësimdhënësi/ja ia parashtron nxënësve këto pyetje: Cili ishte synimi i fiseve barbare? Kush qëndronte në krye të fiseve gjermane? Cilat fise të tjera të njohura kanë histori dyndjesh? Si quhen njerëzit që merreshin vetëm me lutje ndaj zotit? Nga kush drejtohen kishat dhe manastiret, etj. Të gjitha përgjigjet që merren, mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë. Nxënësit vazhdojnë të diskutojnë për përgjigjet që japin dhe të japin argumentet e tyre për atë që pajtohen dhe nuk pajtohen me mendime. Pas përfundimit të diskutimit, mësimdhënësi/ja vazhdon me realizimin e pjesës kryesore të orës.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të zhvillimit të orës mësimore, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ta janë më interesante dhe më të rëndësishme. Pjesa e përzgjedhur dhe numri i faqes shënohen në një fletëz, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për pjesën e përzgjedhur të njësisë. P.sh.(Pse e kanë përzgjedhur pjesëzën që flitet për shoqëritë barbare cili është mesazhi, rëndësia etj). Njëri nga nxënësit e tregon faqen se ku e ka zgjedhur pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit, të tjerët diskutojnë rreth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentin e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komentit, nxënësit të tjerë nuk kanë të drejtë të japin komente shtesë. E njëjta ecure e leximit të citatit dhe komentimit praktikohet edhe tek nxënës të tjerë.

Pjesa përfundimtare:

Nxënësit së pari në ndahen në dyshe, më pastaj në grup diskutojnë për pjesën që kanë lexuar, pastaj diskutojnë për informacione të reja dhe më në fund nxjerrin përfundime. Mësimdhënësi/ja angazhon një anëtar të grupit për të dhënë përfundimet e nxjerra gjatë bashkëbisedimit. Anëtari i grupit mund të përzgjidhet edhe në këtë formë: Nxënësit i vendosin lapsat mbi bankë. Mësuesja e bën përzgjedhjen e një lapsi, atëherë grupin do ta përfaqësojë ai nxënës/e, lapsin e të cilit e përzgjedh mësimdhënësi/ja.

Aktivitete shtesë:

Nxënësit në mënyrë individuale shkruajnë një shkrim të lirë për dyndjet e popujve, rëndësinë dhe pasojat e dyndjeve.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen sipas bashkëpunimit në grup.
Në punë individuale.

5. FRANKËT FORMOJNË SHTETIN E TYRE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.
3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.

RNSH:Kompetenca I 4; 6. II 1; 5. III 2.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Përkufizon rrethanat e krijimit dhe fuqizimit të shtetit frank dhe vlerëson rolin e Karlit të Madh në formimin e Perandorisë së Shenjtë Romake.
- Identifikon kodet juridike evropiane dhe bizantine dhe përkufizon rolin e tyre në organizimin e shoqërisë.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Frankët, merovingët, e Drejta Salike, majordomët, duka, konti.

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja për të lidhur emocionalisht nxënësit me njësinë e re, paraqet katër terma që përdoren shpesh në njësinë mësimore. Caktohen katër terma, p.sh. Frankët, Pepini i vogël, shteti i Papës dhe reforma në ushtri. Nga këto fjalë nxënësit janë të obliguar që (për 5 min.) të thurin një ngjarje apo fjali me kuptim ku përfshihen këto katër terma. Më pas nxënësit në dyshe shkëmbejnë ngjarjet e thurura nga fjalët kyçe.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore, së pari formohen grupe nxënësish me po aq anëtarë sa edhe ka pjesë mësimi. Meqenëse njësia mësimore „Shteti i Frankëve”, është e ndarë në tre kapituj, siç janë: „ Frankët në kohën e merovingëve “, Përpjeke për reformat në ushtri” dhe „ Karli i madh fuqizon shtetin e frankëve”, atëherë edhe klasa ndahet në tri grupe. Mësimdhënësi/ja i jep udhëzime se si do të punohet: Hapat e punës janë: Leximi bëhet me ndalesa pas secilës pjesë. Lexojnë të gjithë anëtarët e grupit pjesën e parë. Një anëtar i grupit luan rolin e mësuesit, që puna e tij ka tri role, siç janë: 1) Shpjego kuptimin e pjesës së lexuar, 2) jep përgjigje, sqarime

në pyetjet e anëtarëve dhe 3) parashtrojnë pyetje të anëtarëve të grupit. Pas përfundimit të kësaj pjese, nxënësi që luan rolin e mësuesit/es, për leximin paraprak cakton një anëtar tjetër të grupit si mësues dhe vazhdohet si në pjesën e parë.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësuesi/nxënësi/ja shkruan në dërrasë të zezë një pyetje me mundësi të përgjigjes, me PO ose JO. P.sh. „A ka nevojë që NATO-ja të qëndrojë në Kosovë, nëse Kosova ka ushtri të formuar”? Nëse nxënësit përgjigjen me po, ose jo, atëherë kërkohet të argumentohet.

Po	Jo

Aktivitetet Shtesë:

Nxënësit e ndarë në grup, udhëzohen që të diskutojnë për shtetet që u formuan pas rënies së Perandorisë Romake

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punë individuale.

Për bashkëpunim dhe angazhim në grup.

Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimeve në klasë.

6. VIKINGËT

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH:Kompetenca I 2; 4. II 1; 6. VI 5.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:.

Nxënësi/ja:

- Përshkruan invazionet e vikingëve dhe analizon rrjedhojat e tyre në rrafshin shoqëror dhe politik në Evropë e më gjerë.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Vikingë, detarë, luftëtarë, gërshetim

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, arti pamor.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi i nxit nxënësit që të mendojnë lirshëm se çfarë dinë për vikingët? Nxënësit udhëzohen të shkruajnë në fletoret e tyre çdo gjë që u kujtohet për vikingët, pa menduar a kanë të drejtë apo jo. Ky aktivitet mund të zhvillohet në punë individuale, dyshe apo edhe grup. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve i shkruan në tabelë dhe bën një degëzim sipas rendit logjik.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të lexojnë njësinë mësimore. Njësia mësimore është e ndarë në tre nëntituj: Kush ishin vikingët?, Vikingët ishin luftëtarë të shquar dhe Gërshetimi kulturor dhe pranimi i krishterimit nga popujt skandinavë. Leximi të bëhet në mënyrë individuale. Nxënësit lexojnë vetëm pjesën e parë dhe mbyllin tekstin. Pas leximit të pjesës së parë, nxënësve iu parashtrohen pyetje: p.sh.Për popujt e cilave vende bëhet fjalë? Prej nga rrjedh fjala viking? Cilat janë argumentet që mund të ofroni? Cilat ishin profesionet e preferuara të tyre? Si mund t'a argumentoni? etj. Pas përfundimit të pjesës së parë, nxënësit vazhdojnë të lexojnë pjesën e dytë të njësisë mësimore. Pasi të përfundojnë leximin, mësimdhënësi/ja parashtrohet pyetje për Vikingët ishin luftëtarë të shquar. Cila periudhë njihet si periudha e vikingëve? Pse autori i paraqet vikingët si dominues

në gërshetim të kulturave? A mendoni se autori mund të ketë simpati për vikingët andaj i paraqet si njerëz shumë të zotët?, etj.

Pastaj vazhdojnë të lexojnë pjesën e tretë të njësisë mësimore Gërshetimi kulturor dhe pranimi i krishterimit nga popujt skandinavë. Mësimdhënësi/ja mund të vazhdojë me pyetje të cilat do të nxisin nxënësit për të dhënë përgjigje duke u bazuar në të menduarit kritik. Përveç mësimdhënësit/es që parashtron pyetje, edhe nxënësit duhet të nxiten t'i parashtrojnë pyetje njëri-tjetrit, apo më një fjalë të zhvillohet një nxënie interaktive. Përdorimi i kësaj teknike mban gjallë kureshtjen e fëmijëve për të gjetur argumentet më të mëdha për të arsyetuar mendimin e tyre.

Ky aktivitet mund të organizohet edhe përmes grafikonit:

Çfarë mendoni për:	Çfarë argumentesh keni:

Pjesa përfundimtare:

Për reflektim, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të shkruajnë një pesëvargësh. Klasa e ndarë në tri grupe të mëdha kanë për detyrë të shkruajnë për Kush ishin vikingët?, Vikingët ishin luftëtarë të shquar dhe Gërshetimi kulturor dhe pranimi i krishterimit nga popujt skandinavë. Ecuria e zbatimit të kësaj teknike, është kjo: Të shkruhet emri i temës, në fletore apo në dërrasës së zezë. Në vargun e dytë shkruhen dy mbiemra, në vargun e tretë tri folje, në vargun e katërt një fjali dhe në vargun e pestë sinonimi.

Aktivitete shtesë:

Nxënësit në mënyrë individuale imagjinojnë një ide, se si ishte pamja e jashtme e vikingëve. Pasi që të paraqesin idetë në grup, grupi përzgjedh idenë më të mirë, përshkruan në formë eseje, e më pastaj prezantojnë në klasë. Përzgjidhet ideja më kreative e cila ekspozohet në murin e klasës.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për angazhim në grup
Për angazhim dhe bashkëpunim në grup
Për cilësinë e krijimeve të tyre

7. DYNDJET E SLLAVËVE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimit, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

RNSH:Kompetenca I 2; 8. II 2. III 7.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon disa nga shkaqet e dyndjeve të popujve, rrjedhojat e ngulitjeve të tyre në Evropë dhe identifikon formacionet e reja shtetërore.
- Përkufizon rrethanat e dyndjeve dhe ngulitjeve të sllavëve në Evropën Juglindore.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Sllavët, dyndje, lindjes, perëndimit, jugut

Burimet: Libri, interneti, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësve u jepet një temë apo u shtrohet një pyetje që ata janë të lirë të shkruajnë rreth asaj teme, apo pyetjeje. Në këtë rast nxënësit udhëzohen që të shkruajnë rreth pyetjeve: Kush janë sllavët, si ndahen ata, dhe prej nga e kanë prejardhjen. Nxënësit shkruajnë lirshëm rreth kësaj teme. Më pastaj lexohet nga një shkrim prej secilit grup.

Pjesa kryesore:

Nxënësit ndahen në katër grupe, me nga katër anëtarë. Ata brenda grupeve numërohen: 1,2,3,4, në mënyrë që secili grup të ketë katër anëtarë, prej 1 deri në 4. Nxënësit njoftohen për mësimin që do ta mësojnë. Nxënësit njoftohen se njësia mësimore është e ndarë në katër pjesë: 1.) Sllavët e vjetër, 2) Sllavët e Jugut, 3.) Sllavët e Perëndimit 4.) Sllavët e Lindjes. Nxënësit që kanë numrin 1 janë përgjegjës që të mësojnë për Sllavët e vjetër, nxënësit që kanë numrin 2, janë përgjegjës të mësojnë për pjesën e njësise Sllavët e Jugut dhe kështu vazhdon deri në pjesën e katërt. Qëllimi përfundimtar është që secili nxënës t'i mësojë katër pjesët e njësise. Pas leximit të pjesëve të njësise, nxënësit që kanë numrin 1 ulen së bashku, nxënësit me numër 2 po ashtu ulen bashkë, e kështu me radhë deri në numrin katër. Nxënësit njoftohen se grupet e formuara tani quhen grupe ekspertësh, ndërsa grupet fillestare quhen grupe familjare apo të bashkëpunimit.

Grupet e ekspertëve duhet të njoftohen se pas mësimit të pjesës (pas 10 deri 15 minutash) duhet të kthehen në grupe familjare dhe atje t'ua shpjegojnë anëtarëve të tjerë të grupit pjesën që kanë mësuar. Po ashtu edhe grupet e ekspertëve fillojnë të mësojnë bashkërisht pjesën e tyre dhe të shkëmbejnë pyetje në mes vete. Të dy grupet si përfundim mund t'i shënojnë të gjitha paqartësitë që kanë dhe pastaj të diskutojnë së bashku. Kështu kompletohet shpjegimi i gjithë përmbajtjes.

Pjesa përfundimtare:

Pjesa reflektuese e orës mësimore vazhdon, kur mësimdhënësi/ja secilit grup ia jep nga një fletë, në të cilën është e shkruar ndonjëra prej këtyre temave që i kanë mësuar në realizim të kuptimit. Kur grupet ta kryejnë punën në fletën e vet, fletat përcillen nga një grup te tjetri, derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Aktivitete Shtesë:

Nxënësit e ndarë në grupe, hulumtojnë në internet për shpërnguljen e shqiptarëve gjatë periudhave historike.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin në grup.

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre individual dhe grupor.

Nxënësit vlerësohen për iniciativë dhe vendimmarrje.

II. QYTETËRIMI BIZANTIN

8. PERANDORIA ROMAKE E LINDJES-BIZANTI GJATË SHEKUJVE V-XI

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor. 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj. 3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.	RNSH: Kompetenca I 2; 3; 4. IV 4.
--	---

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Nxënësi/ja: - Përshkruan faktorët që ndikuan në ngritjen, forcimin dhe zgjerimin e Bizantit si dhe vlerëson kontributin e Justinianit si perandor reformatör. - Identifikon shkaqet që ndikuan në dobësimin e Bizantit dhe dallon faktorët e brendshëm e të jashtëm që ndikuan në rënien e tij. - Identifikon kodet juridike evropiane dhe bizantine dhe përshkruan rolin e tyre në organizimin e shoqërisë.
--

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë Fjalët kyçe: Bizant, Kodi i Justinianit, autokraci, ndërtime. Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, art.
--

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja orën mësimore e fillon me bisedë me nxënësit në formë të pyetje-përgjigjeve me nxënësit. Nxënësit mund të mundësohet të përgjigjen lirshëm në pyetje: Mësimdhënësi/ja mund t'i parashtrojë këto pyetje: Shpjegoni kuptimin e termave dhe koncepteve: Autokraci, Kodi i Justinianit, kryengritjet, universiteti, filozofia dhe drejtësia. Këto pyetje u mundësojnë nxënësit të japin përgjigje të ndryshme.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të zhvillimit të orës mësimore, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ta janë më interesante dhe më të rëndësishme. Pjesa e përzgjedhur dhe numri i faqes shënohen në një fletëz, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për pjesën e përzgjedhur të njësisë. P.sh.(Pse e kanë përzgjedhur njësinë që flitet për Perandorinë Romake të Lindjes etj.). Njëri nga nxënësit e tregon faqen se ku e ka zgjedhur pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit të tjerët diskutojnë rreth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentin e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komenti, nxënësit e tjerë nuk kanë të drejtë të japin komente shtesë. E njëjta ecure e leximit të citatit dhe komentimit praktikohet edhe tek nxënës të tjerë.

Pjesa përfundimtare:

Nxënësit të ndarë në dyshe, e pastaj në grup, diskutojnë për pjesën që kanë lexuar, pastaj diskutojnë për informacione të reja dhe në fund nxjerrin përfundime. Mësimdhënësi/ja angazhon nga një anëtar të secilit grup për të përmbledhur përfundimet dhe rekomandimet që dalin gjatë bashkëbisedimit.

Aktivite shtesë:

Nxënësit udhëzohen të bëjnë kërkime në internet për ndikimet e artit dhe arkitekturës bizantine në vendin tonë.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punën individuale

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në art

Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimit

9. EDUKIMI DHE ARSIMIMI I NJERËZVE NË PERANDORINË BIZANTINE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.

RNSH: Kompetenca I 1; 5; IV 2. VI 5.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon avancimet shkencore, teknike-teknologjike gjatë mesjetës dhe shpjegon ndikimin e tyre në shoqëri.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: shkollim, nivele, retorikë, manastir

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, gjuhë, gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësve u jepet një temë apo u shtrohet një pyetje dhe janë të lirë të shkruajnë rreth asaj teme, apo pyetjeje. Në këtë rast nxënësit udhëzohen që të shkruajnë rreth pyetjeve: A ekzistonin shkollat në Perandorinë Bizantine? Cilat ishin nivelet e shkollimit? Kush kishte të drejtë shkollimi? Në çfarë shkolla kishin të drejtë të shkolloheshin? Nxënësit shkruajnë lirshëm rreth kësaj teme. Më pastaj lexohet nga një shkrim prej secilit grup.

Pjesa kryesore:

Nxënësit ndahen në pesë grupe, me nga pesë anëtarë. Ata brenda grupeve numërohen: 1,2,3,4, 5, në mënyrë që secili grup të ketë katër pesë, prej 1 deri në 5. Nxënësit njoftohen për mësimin që do ta mësojnë. Nxënësit njoftohen se njësia mësimore është e ndarë në pesë pjesë: 1.) A kanë shkuar fëmijët në shkollë, 2.) Edukimi i fëmijëve dhe fazat e shkollimit, 3.) Arsimi fillor 4.) Shkolla e mesme dhe 5.) Arsimi i lartë.

Nxënësit që kanë numrin 1 janë përgjegjës që të mësojnë për A kanë shkuar fëmijët në shkollë, nxënësit që kanë numrin 2, janë përgjegjës të mësojnë për pjesën e njësies Edukimi i fëmijëve dhe fazat e shkollimit, dhe kështu vazhdon deri në pjesën e pestë. Qëllimi përfundimtar është që secili nxënës t'i mësojë të pesë pjesët e njësies. Pas leximit të pjesëve të njësies, nxënësit që

kanë numrin 1 formojnë një grup së bashku, nxënësit me numër 2 po ashtu formojnë një grup bashkë, e kështu me radhë deri në numrin pesë. Nxënësit njoftohen se grupet e formuara tani quhen grupe ekspertësh, ndërsa grupet fillestare quhen grupe familjare apo të bashkëpunimit. Grupet e ekspertëve duhet të njoftohen se pas mësimit të pjesës (pas 10-15 minutash) duhet të kthehen në grupe familjare dhe atje t'ua shpjegojnë anëtarëve të tjerë të grupit pjesën që kanë mësuar. Po ashtu, edhe grupet e ekspertëve fillojnë të mësojnë bashkërisht pjesën e tyre dhe të shkëmbejnë pyetje në mes vete. Të dy grupet si përfundim mund t'i shënojnë të gjitha paqartësitë që kanë dhe pastaj të diskutojnë së bashku. Kështu kompletohet shpjegimi i gjithë përmbajtjes.

Pjesa përfundimtare:

Pjesa reflektuese e orës mësimore vazhdon, kur mësimsdhënësi/ja secilit grup ia jep nga një fletë, në të cilën është e shkruar ndonjëra prej këtyre temave që i kanë mësuar në realizim të kuptimit. Kur grupet ta kryejnë punën në fletën e vet, fletët përcillen nga një grup tek tjetri derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera. Kjo metodë krijon mundësi që lëshimet eventuale të mënjanojnë, njëherësh krijon ndjenjën e përgjegjësisë tek nxënësit.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit lexojnë në mënyrë individuale njësinë mësimore. Pasi të lexojnë, secili grup e bën përzgjedhjen e një nxënësi i cili ka për detyrë që të bëjë intervista në grup në raport me njësinë.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual dhe grupor
Nxënësit vlerësohen për gatishmëri dhe bashkëpunim në grup
Nxënësit vlerësohen në komunikim

10. PERSONALITETE TË SHQUARA TË PERANDORISË BIZANTINE GJATË SHEKUJVE V-XII

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH: Kompetenca I 2; 4; 6. III 1; 2.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon personalitetet më të spikatura nga fusha e artit, kulturës, shkencës, teknologjisë e politikës, në Mesjetë, dhe vlerëson veprimtarinë e kontributin e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Personalitete, Justiniani I, Belisari, Konstadini, Niketa, Ana Komnena

Burimet: Libri, foto, burime nga interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Art

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Kjo fazë e mësimin zhvillohet në formë të pyetjeve dhe të përgjigjeve me nxënësit. Mësimdhënësi/ja i nxit nxënësit që të përgjigjen në mënyrë individuale, duke i dhënë të drejtë të gjithë nxënësve që të debatojnë për pyetjet që ia parashtron mësimdhënësi/ja në raport me njësinë mësimore. Mësimdhënësi/ja ia parashtron nxënësve këto pyetje: Cilat ishin figurat më të rëndësishme në Perandorinë Bizantine? Cilët ishin Perandorët më të njohur të Perandorinë Bizantine? Argumentoni veprat e tyre pse mendoni se këto personalitete ishin të një rëndësie të veçantë? Si quhen njerëzit që merreshin vetëm me lutje ndaj zotit? etj. Të gjitha përgjigjet që merren, mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë. Nxënësit vazhdojnë të diskutojnë për përgjigjet që japin dhe të japin argumentet e tyre për atë që pajtohen dhe nuk pajtohen me mendime. Pas përfundimit të diskutimit, mësimdhënësi/ja vazhdon me realizimin e pjesës kryesore të orës.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore, së pari formohen grupe nxënësish me po aq anëtarë sa edhe ka pjesë mësimi. Meqenëse njësia mësimore është e ndarë sipas disa figurave të shquara historike, siç janë: Justiniani I, Flavius Belisarius, Konstandin VII Porfirogjeni, Niketa Koniates, Ana Komnena dhe Mihal Ataliati, atëherë edhe klasa ndahet në po aq grupe. Mësimdhënësi/ja i jep udhëzime se si do të punohet: Hapat e punës janë: Leximi bëhet me ndalesa pas secilës pjesë.

Lexojnë të gjithë anëtarët e grupit pjesën e parë. Një anëtar i grupit luan rolin e mësuesit, që puna e tij ka tri role, siç janë: 1) Shpjego kuptimin e pjesës së lexuar, 2) jep përgjigje, sqarime në pyetjet e anëtareve dhe parashtro pyetje te anëtarët e grupit. Pas përfundimit të kësaj pjese, nxënësi që luan rolin e mësuesit/es, për leximin paraprak cakton një anëtar tjetër të grupit si mësues dhe vazhdohet si në pjesën e parë.

Pjesa përfundimtare:

Mësimdhënësi/ja secilit grup ia jep nga një fletë, në të cilën është e shkruar ndonjëra prej këtyre temave që i kanë mësuar në realizim të kuptimit. Secili nxënës i grupit pasi të kryejnë punën në fletën e vet, fletët vazhdojnë të përcillen nga një grup tek tjetri, derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera (Rishikim me rigrupim).

Aktivitete shitesë:

Në klasë debatojnë për personalitete të ndryshme.
Përzgjidhet një nxënës/e që do ta udhëheqë debatin.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen në komunikim
Në përgjigjet, idetë dhe sugjerimet që japin në pyetjet e parashtruara nga nxënësit
Në aftësitë drejtuese dhe në nivelin e vetëbesimit.

III. ARBËRIA GJATË SHEKUJVE V-XIV

11. NGA ILIRIA NË ARBËRI DHE NGA ILIRËT NË ARBËR

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor. 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimet, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.	RNSH: Kompetenca I 3. II 1; 2; 6; 7.
---	---

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Përkufizon shtrirjen territoriale të arbërve dhe identifikon veçoritë kulturore dhe marrëdhëniet shoqërore tek ta.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Gjuhë, arbër, Arbëri

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë, gjeografi, arkeologji

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Për këtë njësi mësimore mund të përdoret Di / Dua të di / Mësoj, si teknikë e vetme e cila përmban në vete të tri fazat e orës mësimore. Fillimisht mësimdhënësi i njofton nxënësit për temën, dhe i udhëzon që gjatë punë individuale të formojnë një tabelë në fletoret e tyre, ashtu siç e bën vetë mësimdhënësi në tabelën e zezë, duke formuar tri kolona dhe të plotësojnë atë sipas kërkesës në secilën kolonë. Në kolonën e parë udhëzohen të shënojnë të gjitha informatat që kanë për temën, në këtë rast për arbrit dhe Arbërinë. Pasi të përfundojnë do të diskutojnë në grup për të shkëmbyer idetë mes tyre, pas pesë minutave përmbledhjen e ideve do ta prezantojnë për tërë klasën. Mësimdhënësi/ja do të shënojë të gjitha mendimet e nxënësve në tabelë, duke kërkuar që të shënojnë edhe ata çdo gjë që reflektojnë nxënësit e tjerë.

Di	Dua të di	Mësoj

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në kolonën e dytë do të plotësojnë të gjithë atë që u intereson për temën – Arbërinë dhe arbitrit. Pastaj do të lexojnë në mënyrë individuale njësine mësimore, duke qenë të kujdesshëm dhe të mbajnë shënime për të plotësuar tabelën rreth informatave që marrin gjatë leximit. Pasi të kenë përfunduar do të bashkëbisedojnë në grup për të reflektuar për informacionet e ndryshme që kanë hasur në tekst.

Pjesa përfundimtare:

Pasi të kenë përfunduar diskutimet në grup, kërkohet nga mësimdhënësi dhe nxënësit të reflektojnë dhe të shkëmbejnë informacionet e reja që dalin gjatë leximit. Ndërkohë mësimdhënësi shpjegon dhe sqaron konceptet kryesore të mësimi: Gjuha, territori, kulturë, asimilim, doket, zakonet, etj. Të gjitha idetë e nxënësve shënohen në tabelë, dhe njëkohësisht bëhen pyetje të ndryshme për të vërtetuar se a ishin plotësuar njohuritë e nxënësve nga teksti që kishin lexuar.

Duke marrë informacionet, mësimdhënësi si detyrë shtëpie mund të kërkojë nga nxënësit të bëjnë punë hulumtuese në internet.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit hulumtojnë në internet për monumentet kulturo-historike

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punën individuale

Për punën në grup.

Për punën hulumtuese.

12. JETA E PËRDITSHME NË ARBËRI

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimet, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

RNSH: Kompetenca V 2; 8. VI 1.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Dallon elementet kryesore të trashëgimisë kulturore iliro-arbërore dhe vlerëson rëndësinë e tyre.
- Ilustron aspekte të jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Vendbanim, kështjella, fortifikata, ushqim, ngrohje, ndriçim


Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, arkeologji, art pamor.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi i nxit nxënësit që të mendojnë lirshëm se çfarë dinë për temën “Jeta e Përditshme”? Nxënësit në mes të fletores e shkruajnë *arbrit*, duke krijuar një degëzim rreth asaj se ç’dinë për vendbanimet mesjetare, për veshjet e tyre, ushqimin, etj.(Kllasteri apo Pema e mendimit) Ky aktivitet zhvillohet në dyshe. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve i shkruan në tabelë dhe bën një degëzim sipas rendit logjik.



Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës, mësime dhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të lexojnë pjesën mësimore. Njësia mësimore është e ndarë në katër nëntituj: Vendbanimet dhe shtëpitë; Me çka ushqeheshin shqiptarët në mesjetë; Ngrohja dhe ndriçimi në shtëpitë mesjetare dhe Veshjet.

Leximi bëhet në mënyrë individuale. Nxënësit lexojnë vetëm pjesën e parë dhe mbyllin tekstin.

Pas leximit të pjesës së parë, nxënësve u parashtrohen pyetje me qëllim të zhvillimit të menduarit kritik: p.sh. Çfarë lloj vendbanimesh kishte në Arbëri? Cila ishte arsyeja që jetonin përgjatë luginave të lumenjve? Çfarë ju bën të mendoni në këtë mënyrë? etj.

Pas përfundimit të pjesës së parë, nxënësit vazhdojnë të lexojnë pjesën e dytë të njësisë mësimore

Pasi të përfundojnë leximin, mësime dhënësi/ja parashtrohet pyetje për konsumin e ushqimit? etj.

Pastaj vazhdojnë të lexojnë pjesën e tretë të njësisë mësimore. Mësime dhënësi/ja parashtrohet pyetje me qëllim të nxitjes për të argumentuar idetë e reflektuara etj. E njëjta vlen edhe për pjesën e katërt për veshjet dhe stolitë që arbërit kanë përdorur, por gjithnjë duke u munduar të nxirren fakte argumentuese. Përveç mësime dhënësit/es parashtrohet pyetje, edhe nxënësit duhet të nxiten t'i parashtrojnë pyetje njëri-tjetrit, apo me një fjalë të zhvillohet një nxënie interaktive.

Pjesa përfundimtare:

Për reflektim, mësime dhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të shkruajnë një pesëvargësh. Klasa e ndarë në katër grupe të mëdha të cilët kanë për detyrë të shkruajnë për Vendbanimet dhe shtëpitë; Me çka ushqeheshin shqiptarët në mesjetë; Ngrohja dhe ndriçimi në shtëpitë mesjetare dhe Veshjet. Ecuria e zbatimit të kësaj teknike, është kjo: Të shkruhet emri i temës, në fletore apo në dërrasës së zezë. Në vargun e dytë shkruhen dy mbiemra, në vargun e tretë tri folje, në vargun e katërt një fjali dhe në vargun e pestë sinonimi.

Aktivitete shitesë: Grupet e nxënësve përgatitin nga tri pyetje për grupet e tjera. Grupet përzgjedhin udhëheqësin e grupit, i cili ka për detyrë të prezantojë grupin.

Vlerësimi:

Vlerësimi në bashkëpunim në grup dhe angazhim.

Në cilësinë e udhëheqjes dhe prezantimit të detyrës.

13. ARBËRIT NË PERANDORINË BIZANTINE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.

RNSH:Kompetenca I 4. II 2, 7. III 5.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Përshkruan pozitën e iliro-arbërve si pasojë e ndarjes së Perandorisë Romake (Vija e Teodosit) dhe shqyrton rrjedhojat e ndarjes së Kishës (1054) te ta.
- Përshkruan reformat politike-administrative dhe shoqërore të Perandorisë Romake të Lindjes-Bizantit, dhe diskuton për pozitën e arbërve brenda këtij sistemi.
- Identifikon personalitetet më të spikatura nga fusha e artit, kulturës, shkencës, teknologjisë e politikës, në Mesjetë, dhe vlerëson veprimtarinë e kontributin e tyre.
- Përshkruan faktorët që ndikuan në ngritjen, forcimin dhe zgjerimin e Bizantit si dhe vlerëson kontributin e Justinianit si perandor reformator.
- Identifikon kodet juridike evropiane dhe bizantine dhe përshkruan rolin e tyre në organizimin e shoqërisë.
- Shpjegon veçoritë kryesore të feudalizmit dhe arsyet e lindjes së shtresave të reja shoqërore.
- Identifikon shtresat shoqërore, marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe evidencon të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Perandori, Bizant, Arbëri, Justiniani I, Provincë

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: edukatë qytetare, arkeologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mendo puno në dyshe. Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja kërkon nga anëtarët e grupit që të bashkohen në dyshe, dhe më pas të veprohet sipas këtyre hapave: Njëri nga anëtarët në çift ka për detyrë të shkruaj një temë, P.sh. Përshkruani se çfarë e bën një vend të caktuar të

ketë pozitë të mirë gjeografike? Ndërsa anëtari tjetër i çiftit përshkruan rëndësinë e sigurimit të kështjellave dhe fortifikatave për mbrojtje nga sulmet eventuale të armikut? Pasi të kenë përfunduar të shkruarit, dyshet shkëmbejnë përvojat. Në fund brenda secilit grup, një apo dy dyshe tregojnë përvojat për të cilat kanë shkruar, dhe diskutimi vazhdon me pyetje të tjera që rrjedhin nga situatë në klasë.

Pjesa kryesore:

(Mësimdhënia e ndërsjellë) Në këtë fazë të orës mësimore formohen grupe nxënësish me po aq anëtarë sa ka edhe pjesë të mësimit. Mësimdhënësi/ja jep udhëzime se si të punohet. Leximi bëhet me ndalesa pas secilës pjesë, fillojnë të lexojnë të gjithë anëtarët e grupit, pjesën e parë. Një anëtar i grupit luan rolin e mësuesit. Puna e tij ka tri role: 1.) Shpjegon kuptimin e pjesës së lexuar, 2.) Jep përgjigje, sqarime në pyetjet e anëtarëve të grupit, 3) Bën pyetje për anëtarët e tjerë të grupit si një mësues për leximin vijues. Vazhdojnë me leximin e dytë nga të gjithë anëtarët e grupit. Vazhdohet si në pjesën e parë. Puna mund të bëhet në grupe, nëse grupet kanë anëtarë aq sa ka pjesë mësimi.

Pjesa përfundimtare:

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë (dërrasë të zezë) emrin e temës, apo një emër që ka të bëjë me këtë temë. Meqenëse në këtë njësi kemi të bëjmë me arbitrin në Perandorinë Bizantine, atëherë si temë marrim vetëm fjalën „Bizanti”. Fjalën Bizanti e shkruajmë në tabelë, po ashtu edhe nxënësit, më pastaj vazhdojmë: Nën emër shënojmë dy mbiemra, që nxënësit së pari në mënyrë individuale i shkruajnë, pastaj vazhdojmë me tri folje, një fjali përfundimtare dhe me sinonimin e fjaliës.

1. _____ Bizanti
2. Dy mbiemra _____
3. Tri folje _____
4. Një fjali _____
5. Sinonimi _____

Aktivitete shitesë:

Nxënësit bëjnë dialog për temën: E drejta e popujve për liri

Nxënësit përzgjedhin një moderator/e i/e cili/a do të udhëheqë debatin. Nxënësit gjatë diskutimeve, mund të nxjerrin edhe përfundime.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për aktivizimin e tyre në debat

Nxënësit vlerësohen për respektin ndaj të tjerëve

Nxënësit vlerësohen për bashkëveprimin me të tjerët.

14. TREVAT ARBËRORE-SHQIPTARE NËN PUSHTIMIN BULLGAR GJATË SHEKUJVE IX-X

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.	RNSH: Kompetenca I 2. II 1; 2; 7. III 6. IV 4.
---	---

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhojat për shoqërinë evropiane.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Trojet arbërore, Bullgari, thema, rivalitet

Burimet: Libri, burime interneti, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, gjeografi

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi ju drejtohet nxënësve me pyetjet: Nën sundimin e kujt gjendeshin territoret ilire gjatë mesjetës? A njihni ndonjë perandor ilir që ka udhëhequr Perandorinë Bizantine? Keni dëgjuar për Samuilin, a e dini se cilit shtet i takonte? Deri sa nxënësit të reflektojnë, mësimdhënësi/ja paraqet idetë e tyre në tabelë, po ashtu edhe nxënësit udhëzohen të marrin shënime në fletore.

Pjesa kryesore:

Në vijim do të kërkohet nga nxënësit të lexojnë në mënyrë individuale njësinë e ndarë në pjesë, e cila mund të shfrytëzohet sipas nëntitujve apo sythave të njësisë mësimore. Pas leximit të pjesëzës, nxënësit do të bashkëbisedojnë në çifte, e më pas së bashku me tërë klasën do të reflektojnë duke diskutuar, apo duke zhvilluar një mësimdhënie interaktive për atë çfarë kanë nxënë. Ecuria e punës vazhdon kështu me radhë deri sa të përfundojë e tërë njësia mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë do të kërkohet nga nxënësit të reflektojnë në mënyrë individuale në fletoret e tyre duke paraqitur një degëzim për mes teknikës Kllaster rreth njësisë mësimore. Pasi të përfundojnë kërkohet nga të gjithë të paraqesin atë se çfarë kanë zënë gjatë kësaj ore mësimore. Mësimdhënësi

duhet të shënojë të gjitha idetë e nxënësve në tabelë pasi e gjithë kjo ndihmon në të nxënit në bashkëpunim.

Aktivitete shitesë:

Mësimdhënësi/ja, udhëzon nxënësit/et të përgatisin në PowerPoint përmbajtjen e kësaj njësie mësimore, duke përdorur teknologjinë informative të komunikimit për nevoja pedagogjike.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësve do të bëhet në mënyrë individuale

Vlerësimi në bashkëpunim dhe respektim në grup

Cilësinë e punimeve të prezantuesit të grupit.

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në përdorimin e TIK-ut për nevoja pedagogjike.

15. NDARJA E KISHËS DHE SITUATA NË ARBËRI

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor. 3.2 Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to. 4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme	RNSH: Kompetenca I 3. II 1; 8. IV 4.
---	---

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Përshkruan pozitën e iliro-arbërve si pasojë e ndarjes së Perandorisë Romake (Vija e Teodosit) dhe shqyrton rrjedhojat e ndarjes së kishës (1054) te ta.
- Analizon rolin e kishës në shoqërinë mesjetare, identifikon disa nga urdhërat kryesorë fetarë dhe përshkruan inkuizicionin si mënyrë e luftimit të oponencës ndaj saj.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Krishterim, ndarje, kardinal, perëndim, lindje, katolike, ortodokse

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, religjion.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja iu parashtrohet nxënësve pyetje se a kanë dëgjuar ndonjëherë për Homerin dhe për veprat e tij. A iu pëlqen të vizitojnë teatrin, A kanë dëshirë ndonjëri prej tyre të vazhdojë të studiojë aktrimin, artin etj. Nxënësit bashkëbisedojnë njëri me tjetrin për shfaqjet që i kanë parë në teatër dhe për kulturën në përgjithësi që ka Kosova.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë, në fillim mësimdhënësi/ja i informon nxënësit për atë që do të lexojnë, dhe gjatë leximit, ata do të marrin shënime. Më pas udhëzohen që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale. Ku më pas gjatë leximit, në të majtë të faqes shkruajnë një citat nga teksti (Pjesa që u bën përshtypje), ndërsa në anën e djathtë duhet të shkruhen komentet: Pse jeni përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri të mendoni? Çfarë pyetjesh keni? (koment i përse u bëri përshtypje) etj. Pasi

të lexojnë disa nxënës, kjo varet prej kohës se sa nxënës kanë mundësi të lexojnë, të njëjtin lexim e bën edhe mësimdhënësi/ja. Në fund të leximit kërkohen vullnetarë (2-3 veta) që të japin komentet e tyre. Pas leximit të pjesës që u ka lënë përshtypje, vullnetarët pyeten: Pse u tërhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çfarë u bëri të mendoni? Pyet të tjerët për përzgjedhjen që kanë bërë dhe krejt në fund mund të bëhen këto pyetje? Çfarë keni mbajtur në mend nga ky material?, Cili është mesazhi më i rëndësishëm?

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja në dërrasë të zezë shkruan një pyetje me mundësi të përgjigjes me PO dhe JO. Të njëjtën gjë e bëjnë nxënësit në fletoret e tyre. P.sh. A duhet të angazhohet më shumë shkolla dhe e tërë shoqëria për t'i mësuar nxënësit tonë për religjionin si lëndë mësimore? Në anën e majtë shënojnë Po, ndërsa në anën e djathtë të fletës shënojnë Jo. Pastaj duhet të argumentojnë pse po mendojnë se angazhimi i tyre është i mjaftueshëm, dhe pse nuk është angazhimi i mjaftueshëm. Puna bëhet në çifte. Pastaj çiftet bashkëpunojnë njëri me tjetrin, diskutojnë, krahasojnë dhe shtojnë arsye të tjera në listë. Pastaj të gjithë nxënësit lëvizin nëpër grupe, duke i formuar tri grupe. Grupin që janë për Po, grupin që janë për JO dhe grupin që është i pavendosur. Pastaj, grupet që janë për po dhe grupet që janë për jo, diskutojnë për të përgatitur argumentet e tyre për të forcuar pozicionin që e mbajnë. Hapet diskutimi në mes të anëtarëve të grupit, bëhet një debat, dhe nxënësit që i ndërrojnë bindjet e tyre mund të kalojnë nga një grup në një grup tjetër, por ka mundësi të jenë edhe të papërcaktuar.

Po	Jo
Pse?	Pse?

Aktivitete shitesë:

Secili nxënës në mënyrë individuale do të luajë rolin e shkrimtarit. Nxënësit do të shkruajnë ese me këto fjalë kyçe: Arsimi, kultura, shkolla, besimi dhe teatri. Pas përfundimit, mësuesja udhëzon që nxënësit të lexojnë esetë e tyre.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen në mënyrë individuale

Nxënësit vlerësohen për talentet e tyre

Për cilësinë e prezantimeve

Nxënësit vlerësohen për interesimin e tyre në pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme.

16. THEMAT NË ARBËRI

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH:Kompetenca I 2; 4. II 1. VI 2; 7.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Përshkruan reformat politike-administrative dhe shoqërore të Perandorisë Romake të Lindjes-Bizantit, dhe diskuton për pozitën e arbërve brenda këtij sistemi.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Perandoria Bizantine, themat, stratotika, pronia, bashtina.

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Biologji, jurispodencë, gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi u drejtohet nxënësve me pyetjet: Nën sundimin e kujt gjendeshin territoret ilire në shek. XI? A njihni ndonjë perandor ilir? Cila ishte reforma administrative e territoreve, që bëri Perandoria Bizantine? Keni dëgjuar për fjalën njësi administrative (thema), a e dini se çka janë? Derisa nxënësit të reflektojnë, mësimdhënësi/et paraqesin idetë e tyre në tabelë, po ashtu edhe nxënësit të marrin shënime në fletore.

Pjesa kryesore:

Në vijim do të kërkohet nga nxënësit të lexojnë në mënyrë individuale njësinë e ndarë në pjesë, e cila mund të shfrytëzohet sipas nëntitujve apo sythave të njësisë mësimore. Pas leximit të pjesëzës, nxënësit do të bashkëbisedojnë në çifte, e më pas së bashku me tërë klasën do të reflektojnë duke diskutuar, apo duke zhvilluar një mësimdhënie interaktive për atë çfarë kanë nxënë. Ecuria e punës vazhdon kështu me radhë derisa të përfundojë e tërë njësia mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë do të kërkohet nga nxënësit të reflektojnë në mënyrë individuale në fletoret e tyre duke shkruar një „shkrim të lirë” rreth njësisë mësimore. Pasi të përfundojnë kërkohet nga të gjithë të paraqesin atë se çfarë kanë zënë gjatë kësaj ore mësimore. Mësimdhënësi/ja shënon disa nga idetë e nxënësve në tabelë, e gjithë kjo ndihmon në të nxënës të bashkëpunim.

Aktivitetet shitesë:

Nxënësit e klasës ndahen në katër grupe. Secili grup ka për detyrë të emërojë një udhëheqës/e të grupit. Udhëheqësit/et i/e grupit i udhëzojnë nxënësit/et në grup, që të rekomandojnë ide dhe sugjerime për të krijuar rregulla në shkollë.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësve për bashkëpunim në grup

Vlerësimi i nxënësve për punë individuale.

Vlerësim i nxënësve për përgatitje të projekteve

Vlerësim i nxënësve për performancën në prezantime

17. JETA RURALE DHE QENDRAT URBANE NË ARBËRI

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	------------------------------------	--------------------

RNF: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimt, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.

RNSH:Kompetenca II 1; 6; 8. V 3.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Ilustron aspekte të jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Thema, Durrësi, Nikopoja, Selaniku, Shkupi, stratiot

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Pjesa hyrëse e orës mësimore do të zhvillohet përmes teknikës Stuhi mendimesh. Mësimdhënësi/ja do të parashtrojë pyetje rreth njohurive paraprake që mund të kenë nxënësit rreth zhvillimit të jetesës në zonat rurale dhe urbane në viset e ndryshme të Shqipërisë mesjetare. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve do t'i listojë në tabelë.

Pjesa kryesore:

Më pas do të vazhdojmë me teknikën Kubimi ku mësimdhënësi/ja u drejtohet nxënësve me udhëzimet për t'u dhënë përgjigje pyetjeve: Përshkruani, krahasoni, shoqëroni, analizoni, zbatoni dhe argumentoni. Nxënësit ndahen në grupe, aq sa faqe i ka kubi, nga 4-5 nxënës në secilin grup, dhe u jepet detyrë të lexojnë njësinë mësimore. Nxënësit e lexojnë me kujdes tekstin për të gjetur përgjigjet e pyetjeve. Për secilën nga këto veprime, mësimdhënësi/ja ka përgatitur pyetje e ushtrime, të cilat i ka të shkruara.

Përshkruani: karakteristikat e fshatit dhe qytetit (vendbanimeve të ndryshme).

Krahasoni: jetën e njerëzve në fshatra dhe qytete
Shoqëroni: jetën e njerëzve të Arbërisë me atë të Romës apo Konstatinopolit.
Analizoni: zhvillimin ekonomik të viseve malore, fshatrave dhe qyteteve.
Zbatoni: në kushtet e sotme të jetesës
Argumentoni: duke mbledhur vlerat e të arriturave të shoqërisë.

Pjesa përfundimtare:

Në përmbyllje të njësisë mësimore mund të përdoret teknika *kllaster* ku mësimdhënësi/ja këshillon nxënësit që në mes të fletores të shkruajnë “Mbretëria Maqedone”, dhe nxënësit në grup do të reflektojnë duke shkruar të gjitha informacionet e fituara nga leximi. Mësimdhënësi/ja gjithashtu idetë e grupeve të ndryshme do t’i paraqesë në tabelë.

Aktivitete shtesë:

Nxënësit ndahen në tri grupe. Njëri grup përgjigjet në pyetjen:
A janë i njëjti popull arbit e mesjetës me shqiptarët e sotëm?, grupi i dytë ka për të diskutuar për prejardhjen e shqiptarëve duke u bazuar në argumente, ndërsa grupi i tretë ka për të diskutuar për vazhdimësinë kulturore të iliro-arbërore-shqiptare. Pasi të përfundojnë, grupet në mënyrë interaktive prezantojnë punën e tyre, dhe pastaj vazhdojnë me diskutime.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për punën individuale
Për angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre në grup, për përgjegjësi të barabarta.

18. PRINCIPATAT MESJETARE NË ARBËRISË NË SHEKUJT XII-XIII. PRINCIPATA E ARBËRIT DHE DESPOTATI I ARTËS

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.	RNSH: Kompetenca I 1. II 2; 6; 7.
---	--

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon rrethanat e themelimit të Principatës së Arbrit dhe krahason rolin e prijësve të saj.
- Veçon përfaqësues të dalluar të bujarisë arbërore, faktorët që ndikuan në fuqizimin e tyre, përkufizon principatat e veçanta dhe marrëdhëniet midis tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Principat, familje feudale, Progoni, zgjerim i kufijve, despotat

Burimet: Libri, internet, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, gjeografi

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja fillimisht shënon në tabelë disa fjalë kyçe, prej të cilave kërkon që nxënësit të shkruajnë një tregim të shkurtër me këto fjalë. Fjalët kyçe mund të jenë: Arbër, principatë, shteti shqiptar, Despotati i Artës, territor. Nxënësit/et udhëzohen që të shkruajnë një shkrim të lirë përmes këtyre termave. Pasi që të shkruajnë, dikush prej nxënësve në mënyrë vullnetare e lexon para të gjithë klasës.

Pjesa kryesore:

Në vazhdim mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin në mënyrë individuale duke vendos shenjat: Shenja $\sqrt{}$ (tik) informacion i cili njihet nga nxënësit,
Shenja – (minus) informacion i cili është i ndryshëm nga informacioni që ka pas më parë.
Shenja + (plus) informacion i ri dhe shenja e pikësimit ? (pikëpyetje) informacion i paqartë për nxënësin. Gjatë kohës që lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas plotësojnë tabelën sipas udhëzimeve të mësimdhënësit.

✓	-	+	?

Pjesa përfundimtare:

Për reflektim, mësime nxënësi/ja i udhëzon nxënësit/et që të shkruajnë një pesëvargësh. Gjysma e klasës kanë për detyrë të shkruajnë për arbitrit dhe gjysma tjetër për Despotati i Artës. Ecuria e zbatimit të kësaj teknike, është kjo: Të shkruhet emri i temës në fletore apo në dërrasës së zezë. Në vargun e dytë shkruhen dy mbiemra, në vargun e tretë tri folje, në vargun e katërt një fjali dhe në vargun e pestë sinonimi.

Aktivitetet Shtesë:

Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen të shkruajnë dhe argumentojnë krijimin e principatave shqiptare

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punën individuale
 Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në grup
 Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimit

19. ARBËRIA NËN SUNDIMIN E PERANDORISË SERBE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH:Kompetenca I 2. II 7. III 3.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhojat për shoqërinë evropiane.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Depërtim, shteti i Rashës, Nemanja, Dushani, kishë autoqefale, asimilim

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, histori e artit, gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë do të zbatojmë teknikën *stuhi mendimesh*, duke filluar me pyetjet që nxisin dhe motivojnë për orën mësimore. Mësimdhënësi/ja fillon me pyetje si: A keni dëgjuar për shtetin e Rashkës? Cilit popull të Ballkanit mund t'i takojë? A dini ndonjë figurë të rëndësishme të këtij shteti? Kështu mësimdhënësi/ja mund të fillojë orën mësimore duke i drejtuar përmes pyetjeve rreth temës e cila do të zhvillohet. Pyetjet mund t'i përzgjedhë vetë mësimdhënësi/ja për të nxitur kureshtjen për të lexuar për temën mësimore.

Pjesa kryesore:

Më pas do të vazhdojmë me teknikën *DLTA* ku mësimdhënësi/ja u drejtohet nxënësve me udhëzimet për të dëgjuar me vëmendje pasi ata do të përgjigjen në pyetjet që do parashtron pas çdo ndalese. Meqë njësia mësimore përbëhet nga tre nëntituj atëherë mësimdhënësi/ja njësinë mund ta ndajë në tri pjesë apo pas çdo përfundimi të nëntitullit, u parashtron pyetje në lidhje me atë se çfarë kanë dëgjuar dhe çfarë mendimi kanë lidhur me pjesën që pason në tekst. Tekstin mund ta lexojë vetë mësimdhënësi/ja apo të kërkojë nga ndonjë nxënës i cili lexon bukur dhe rrjedhshëm. Pyetjet që do të mund të ndihmonin për të motivuar nxënësit për të mësuar, p.sh. pas ndalesës së parë: Kush ishte Shtefan Nemanja? A keni ndonjë argument? Cila ishte arsyeja që lidhi miqësi me perandorin bizantin? Në çka bazoheni? etj.. Pastaj vazhdojmë me pjesën e dytë, dhe pas përfundimit pasojnë pyetjet që lidhen me këtë pjesë të tekstit. Kush ishte Stefan

Dushani? Cilat ishin synimet e tij? etj.. Kështu vazhdohet pas çdo pjese të lexuar gjer në fund të njësisë mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të reflektojnë përmes teknikës *diagrami i venit*. Nxënësit në mënyrë individuale do të reflektojnë për të veçantat dhe të përbashkëtat e qeverisjes së sundimtarëve serbë. Më pas do të bashkërendojnë idetë e tyre në grup, dhe në fund do të reflektojnë për tërë klasën. Mësimdhënësi/ja idetë e grupeve të ndryshme i paraqet në tabelë.

S. Nemanja	Të përbashkëtat	S. Dushani

Aktivitete shitesë:

Nxënësve u kërkoni të flasin: së pari se si u është dukur mësimi dhe si u janë ndier gjatë kohës derisa lexohej, dhe së dyti, se si e zhvilloi mësuesi mësimin.

Vlerësimi:

Vlerësim formativ

Nxënësit/et vlerësohen për korrektësinë në përgjigjet e tyre.

Nxënësit/et vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim.

20. PRINCIPATAT ARBËRORE-SHQIPTARE NË SHEK. XIV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.
1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH:Kompetenca I 2. II 1; 8. IV 5.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Veçon përfaqësues të dalluar të bujarisë arbërore, faktorët që ndikuan në fuqizimin e tyre, përkufizon principatat e veçanta dhe marrëdhëniet midis tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Principat, familje bujare, Shpataj, Zenebishi, Topiaj, Balshaj

Burimet: Libri, internet, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, art, gjeografi

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja shpërndan në secilin grup nga një fotografi, të cilat kanë të bëjnë me ushtarët, luftërat, armatimin e luftëtarëve romakë. Ata udhëzohen që të shkruajnë gjërat e para që i mendojnë kur i shikojnë fotografinë, pastaj nxënësit diskutojnë në çifte, pastaj në grup për ngjashmëritë dhe dallimet në mes tyre. Të gjitha idetë e ndryshme të nxënësve shkruhen në tabelë.

Pjesa kryesore:

Nxënësit e ndarë në grupe nga 4-6 anëtarë, udhëzohen të lexojnë tërë njësinë mësimore. Pas 10 min. që përfundojnë leximin, mësimdhënësi/ja me short u cakton grupeve nga një pjesë të njësive mësimore (nëntitull) të cilat kanë për detyrë të hartojnë nga 3 deri në 5 pyetje për grupet e tjera. Çdo grup do të zgjedhë përfaqësuesin e vet për t'iu përgjigjur pyetjeve që vijnë nga grupet e tjera.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë mësimdhënësi/ja të gjitha grupet i pajis me nga një fletë të bardhë të formatit A0, ku nxënësit duhet të formojnë një poster me reflektim nga njësia mësimore. Pastaj përfaqësuesi i

grupit del dhe e prezanton para klasës. Nxënësit e tjerë kanë të drejtë të bëjnë pyetje për të marrë informacion sa më të saktë.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit në grupe mendojnë për ndonjë strategji të mësimdhënies, që mund ta përdorin në fazën e reflektimit. Pasi të japin idetë e tyre, nxënësit së bashku me mësimdhënësin/ën bëjnë përzgjedhjen e idesë më të mirë të cilën edhe e realizojnë në reflektim.

Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për pjesëmarrje në diskutim

Nxënësit/et vlerësohen për angazhim në paraqitjen e ideve

Nxënësit/et vlerësohen për vendimmarrje të drejtë (korrektësi) në përzgjedhjen e ideve më të mira.

21. PRINCIPATA E MUZAKAJVE DHE ARIANITËVE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	------------------------------------	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësitor.
1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH: Kompetenca I 2. II 1; 8. IV 5.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Veçon përfaqësues të dalluar të bujarisë arbërore, faktorët që ndikuan në fuqizimin e tyre, përkufizon principatat e veçanta dhe marrëdhëniet midis tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Principatë, Muzakaj, Arianit, territor, ushtarak

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Për këtë njësi mësimore mund të përdoret *Di / Dua të di / Mësoj*, si teknikë e vetme e cila përmban në vete të tri fazat e orës mësimore. Fillimisht mësimdhënësi i njofton nxënësit për temën, dhe i udhëzon që në punë individuale të formojnë një tabelë në fletoret e tyre, ashtu siç e bënë vetë mësimdhënësi në tabelën e zezë, duke formuar tri kolona dhe të plotësojnë atë sipas kërkesës në secilën kolonë. Në kolonën e parë udhëzohen të shënojnë të gjitha informatat që kanë për temën, në këtë rast për Principatën e Muzakajve dhe të Arianitëve. Pasi të përfundojnë do të diskutojnë në grup për të shkëmbyer idetë mes tyre, pas pesë minutave përmbledhjen e ideve do ta prezantojnë për tërë klasën. Mësimdhënësi/ja do të shënojë të gjitha mendimet e nxënësve në tabelë, duke kërkuar që të shënojnë edhe ata çdo gjë që reflektojnë nxënësit e tjerë.


	Di	Dua të di	Mësoj	

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në kolonën e dytë do të plotësojnë të gjithë ato që u intereson për temën – Arbërinë dhe arbit. Pastaj do të lexojnë në mënyrë individuale njësine mësimore, duke qenë të kujdesshëm dhe të mbajnë shënime për të plotësuar tabelën rreth informatave që marrin gjatë leximit. Pasi të kenë përfunduar do të bashkëbisedojnë në grup për të reflektuar për informacionet e ndryshme që kanë hasur në tekst.

Pjesa përfundimtare:

Në fazën përfundimtare të orës nxënësit në punë individuale do të reflektojnë përmes teknikës *Diagrami i Venit* për ngjashmëritë dhe të veçantat e Principatës së Muzakajve dhe Arianitëve. Më pas do të bashkëpunojnë në grup duke bërë një përmbledhje të ideve individuale në atë grupore. Idetë e përmbledhura të nxënësve do të shkruhen në tabelë nga ana e mësimitdhënësit përmes teknikës *Diagrami i Venit*.



Aktivitete shitesë:

Mësimdhënësi/ja, udhëzon secilin grup që të përgatitë në PowerPoint njësine mësimore Principatat shqiptare. Gjashtë grupe përgatitin tema të ndryshme, p.sh. grupi i parë: Principata e Zenebishve, i dytë: Principata e Shpatajve, grupi i tretë: Principata Topiajve, grupi i katërt: Principata e Balshajve, grupi i pestë Principata e Muzakajve dhe grupi i gjashtë Principata e Arianitëve.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punë individuale

Për bashkëpunim dhe angazhim në grup

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e Tik-ut për hulumtime

22. QYTETET MESJETARE TË KOSOVËS

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH: Kompetenca I 1; 6. II 7. V 3.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon qytetet/vendbanimet kryesore në territorin e Kosovës gjatë Mesjetës dhe krahason mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Fjalë kyçe: Theranda, Peshkopat, koloni, tregti, Novobërda, Pejë, Prishtinë, Shkup. **Burimet:** Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë do të zbatojmë teknikën *stuhi mendimesh*, duke filluar me pyetjet që nxisin dhe motivojnë për orën mësimore. Mësimdhënësi/ja fillon me pyetje si: Cilat janë qytetet kryesore në vendin tonë? Po në Shqipëri? A dini ndonjë qytet që është shqiptar por gjendet në ndonjë shtet tjetër sot? Çfarë mendoni, cilat qytete kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik e kulturor në kohëra më të vjetra? Mendimet e ndryshme të nxënësve listohen në tabelë, gjë që kompletton idetë e nxënësve rreth njësish apo temës për të cilën diskutohet.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë mund të zbatojmë teknikën *Mësimdhënia e ndërsjellë*. Nxënësit e ndarë në grupe, mësimdhënësi/ja i udhëzon se njësinë mësimore do ta lexojnë pjesë – pjesë, të ndarë në paragrafë. ku pas çdo paragrafi do të ketë ndalesa. Nxënësit gjatë zbatimit të kësaj teknike do të luajnë dy role: rolin e mësuesit i cili pas çdo ndalese do t'u shpjegojë anëtarëve të tjerë të grupit, përgjigjet në pyetjet të cilat i parashtrojnë anëtarët e grupit dhe për fund u parashtron ai vetë pyetje anëtarëve të grupit për të vërtetuar se a e kanë kuptuar atë që ai ka shpjeguar. Nëse grupet janë të formuara nga numër çift atëherë secilit i bie të shpjegojnë në mënyrë të barabartë. Në këtë teknikë luhet roli i mësuesit dhe dëgjuesit.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë nxënësit mund të reflektojnë përmes një shkrimi të lirë për jetën, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në qytetet arbërore.

Aktivitete shitesë:

Secili grup ka për detyrë të pikturojë nga një pamje të qyteteve mesjetare.

Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për bashkëpunim në grup

Nxënësit/et vlerësohen për iniciativë dhe vendimarrje.

I. QYTETËRIMI ARAB, MONGOLËT DHE KINEZËT

23. LINDJA E ISLAMIZMIT

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimet, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.

RNSH:Kompetenca I 4. II 1; 8. V 5.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Përkufizon shtrirjen territoriale të arbërve dhe identifikon veçoritë kulturore dhe marrëdhëniet shoqërore të ta.
- Analizon rrethanat shoqërore të lindjes dhe përhapjes së besimit islam dhe përshkruan karakteristikat kryesore të tij.
- Analizon faktorët që ndikuan në bashkimin dhe fuqizimin e botës arabe dhe ndikimin e saj gjatë Mesjetës.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Arabët, beduinët, islamizmi, Muhamedi, libri i shenjtë, Ku'rani, Meka, Medina

Burimet: Libri, harta gjeografike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, religjion, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:


Mësimdhënësi/ja në këtë fazë të orës përdor teknikën *Parashikim me terma paraparakë*. Mësimdhënësi ndan tabelën në dy kolona, në secilën kolonë shkruan nga disa terma: Kolona 1- Arabët, besimi, profeti Muhamed, islamizmi; ndërsa në kolonën e 2- Libri i shenjtë, Kur'ani, Abu Bekir, Kalifati Arab. Në vazhdim mësimdhënësi/ja, klasën e ndan në dy grupe të mëdha, dhe i udhëzon që nga termat e kolonave të tyre të krijojnë një histori të shkurtër. Pasi të përfundojnë, nxënësit vullnetarisht lexojnë krijimet e tyre.

Pjesa kryesore:

Në fazën përmbyllëse nxënësve u kërkohet të zgjedhin një nga çështjet e mëposhtme dhe të japin mendimet, idetë dhe njohuritë që mësuhan rreth tyre. Kjo do të realizohet përmes teknikës *ditari dypjesësh*. Më pas u tregohet që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale. Më pas gjatë leximit, në të majtë të faqes shkruajnë ndonjë mesazh apo citat nga teksti. (pjesa që u bënë përshtypje), ndërsa në anën e djathtë duhet të shkruhen komentet: Pse jeni përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri përshtypje? Çfarë pyetjesh keni? (komenti përse ju bëri përshtypje). Të njëjtin lexim e bën edhe mësimdhënësi/ja . Në fund të leximit kërkohen vullnetarë (2-3 veta) që të japin komentet e tyre. Pas leximit të pjesës që u ka bërë përshtypje, vullnetarët pyetën: Pse ju tërhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çka ju bëri të mendoni? Pyetet nëse ka ndonjë tjetër që e ka zgjedhur të njëjtën pjesë. Pyetet: A ka ndonjë arsye tjetër që e ka zgjedhur atë pjesë. Në fund mësimdhënësi/ja jep komentet e saj/tij të nxjerra gjatë leximit që ai/ajo ka bërë. Në fund shtrohen pyetjet: Çfarë do të mbani mend nga ky material?, Cili është mesazhi më i rëndësishëm? Këtyre pyetjeve, nxënësit u japin përgjigje në formë *brainstorming*.

Pjesa përfundimtare:

Në fazën përfundimtare të orës, nxënësit në punë individuale do të reflektojnë për ngjashmëritë dhe të veçantat e krishterimit dhe islamizmit. Më pas do të bashkëpunojnë në grup duke bërë një përmbledhje të ideve individuale në atë grupore. Idetë e përmbledhura të nxënësve do të shkruhen në tabelë nga ana e mësimdhënësit përmes teknikës *Diagrami i Venit*.



Aktivitete Shtesë:

Mësimdhënësi/ja, udhëzon nxënësit të hulumtojnë në internet dhe për përgatitjen e një projekti me temën „ Besimet, dallimet dhe ndikimi i religjioneve te njerëzit në ditët e sotme”.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme
Nxënësit vlerësohen për bashkëpunim në grup
Nxënësit vlerësohen për qëndrimin e tyre

24. LETËRSIA, SHKENCA DHE KULTURA ARABE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme

RNSH: Kompetenca I 1; 2; 5. II 2. IV 6.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Analizon faktorët që ndikuan në bashkimin dhe fuqizimin e botës arabe dhe ndikimin e saj gjatë Mesjetës.
- Shpjegon kontributin dhe ndikimet reciproke shkencore Lindje-Perëndim në Mesjetë.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Arabët, kulturë, gërshetim, letërsi, shkencë

Burimet: Libri, foto, internet

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Letërsi, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja përmes teknikës stuhi mendimesh, (bisedës në formë pyetje- përgjigjeje), bashkëbisedon me nxënësit. Nxënësit u lejonet shprehja e lirë e mendimeve. Dhënia e mendimeve (ideve) mund të realizohet në mënyrë individuale, çifte dhe në grup. Pyetjet që mund të i parashtrohen nxënësit janë: A keni dëgjuar për Kalifatin Arab dhe për librin “Një mijë e një net”. Cilës kulturë i takon libri „ Një mijë e një net”. A e kanë pasur të zhvilluar pikturën arabët etj. Parashtrimi i këtyre pyetjeve, i mundëson nxënësit që të përgjigjen në mënyrë individuale. E gjithë kjo bëhet me qëllim që nxënësit të kenë më të lehtë që të orientohen në temën që do ta zhvillojnë.

Pjesa kryesore:

Nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit, të përzgjedhin një apo më shumë pjesë të tekstit, që për ata janë më interesante. Pasi të përzgjedhin, nxënësit shkruajnë në një fletës, pjesën e përzgjedhur dhe numrin e faqes, se ku e kanë marrë. Në anën e kundërt të fletës shkruhet një koment për citatin (pse e kanë përzgjedhur atë pjesë, cila është rëndësia e kësaj pjese, çfarë njohuri

të reja keni marrë etj.). Njëri nga nxënësit e grupit e tregon faqen ku e kanë marrë pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pasi që ta lexojnë të tjerët diskutojnë rreth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentën e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komenti nxënësit e tjerë nuk kanë të drejtë të japin komente shtesë. E njëjta ecure e leximit të citatit dhe komentit praktikohet edhe te nxënësit e tjerë.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja i jep secilit nxënës nga një fletë, në të cilën shtrihet një mësim, detyrë, pyetje apo problem. Nxënësit në grup shkruajnë mendimet e tyre për temën, apo pyetjen që i parashtrihet nga mësuesi/ja. Pastaj, kur grupet ta kryejnë punën në fletën e vet, fletat përcillen nga një grup te tjetri derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Aktivitete shtesë:

Nxënësit në mënyrë individuale shkruajnë ese me temën: Letërsia, shkenca dhe kultura arabe. Secili grup vullnetarisht përzgjedh nxënësit që do të lexojnë esetë.

Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për aktivizim në grup

Nxënësit/et vlerësohen për idetë e tyre

Nxënësit/et vlerësohen për respektim të komunikimit në debat

25. MONGOLËT DHE KINEZËT FORMOJNË SHTETET E TYRE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.
1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH:Kompetenca I 2. II 2; 6. VI 5.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon pushtimet mongole në krye me Xhingis Kanin dhe ndikimin e tyre.
- Identifikon aspektet kryesore të qytetërimit kinez gjatë kësaj periudhe.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: mongolët, Xhengis Kani, kinezët, dinastia Min

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja në këtë fazë të orës përdorë teknikën *Parashikim me terma paraprakë*. Mësimdhënësi/ja ndan tabelën në dy kolona, në secilën kolonë shkruan nga disa terma: Në kolonën e parë, mësimdhënësi/ja shkruan këta terma: Mongolët, kinezët, Princi Xhingis Kan dhe Marko Polo. Në kolonën e dytë shkruhen këta terma: Perandoria Mine, Princi Hubilaj, Kina, ushtri. Mësimdhënësi/ja, klasën e ndan në dy grupe të mëdha, grupet i udhëzon që nga termat e kolonave të tyre të krijojnë një histori të shkurtër. Pasi të përfundojnë, nxënësit në mënyrë vullnetare, lexojnë krijimet e tyre.

Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja njësinë mësimore e ndan në katër pjesë. Por, fillimisht i ndan nxënësit në grupe familjare, të cilët do të caktohen me numra nga 1 deri në 4. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër, e kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi. Të gjithë këta nxënës

të caktuar në grupet e tyre në bashkëpunim mësojnë njësinë sa më mirë që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'u shpjegojnë nxënësve të tjerë pjesëzën e mësuar. Për të kuptuar sa më mirë pjesën e njësise mësimore nxënësit parashtrojnë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon deri sa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Pasi të përfundojnë në mësimnxënie, nxënësit shkruajnë një përmbledhje të shkurtë për atë se çfarë kanë mësuar – shkrim i lirë. Më pas, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit e ndarë në grupe të reflektojnë para tërë klasës për atë se çfarë kanë mësuar, por gjithnjë duke pasur kujdes që nxënësit të marrin përgjegjësinë për mësimnxënie të pavarur.

Aktivitete shtesë:

Nxënësit e klasës ndahen në katër grupe. Secili grup ka për detyrë të emërojë një udhëheqës/e të grupit. Udhëheqësit/et i/e grupit i udhëzojnë nxënësit/et në grup, që të rekomandojnë ide dhe sugjerime për të krijuar rregulla në shkollë.

Vlerësimi:

Vlerësim formativ.

Vlerësimi i nxënësve për interesin që shprehin në aktivitete të ndryshme;

Vlerësim i nxënësve në përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin.

I. QYTETËRIMI EVROPIAN GJATË SHEKUJVE XI-XV

26. ZHVILLIMI I FSHATRAVE DHE QYTETEVE EVROPIANE NË MESJETËN E ZHVILLUAR SHEK. XI-XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.	RNSH: Kompetenca I 1; 2. II 1; 6, 7.
---	---

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon rolin e avancimit të zejtarisë dhe tregtisë në lindjen e formave të reja të organizimit të grupeve të interesit (esnafet, gildet, hanzat etj.) në shoqërinë mesjetare.
- Ilustron aspekte të jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalët kyçe: Fshat, produkte bujqësore, tregti, zejтари, qytete

Burimet: Libri, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, biologji

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja fillimisht shënon në tabelë disa fjalë kyçe, prej të cilave kërkon që nxënësit të shkruajnë një tregim të shkurtër me ato fjalë. Fjalët kyçe mund të jenë: Bujqësi, blegtori, artizanat, qytete gjatë shek. XI-XIII dhe Deti Mesdhe. Pasi të krijojnë tregimet e tyre disa nxënës lexojnë para të gjithë klasës.

Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja paraprakisht ndan njësinë mësimore në katër pjesë, p.sh. Qytetet gjatë shekujve XI-XII, Bujqësia dhe blegtorja, zhvillimi i tregtisë, zhvillimi i zejtarisë (artizanalët). Pastaj i ndan nxënësit në grupe familjare, të cilat caktohen me numra 1-4. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër, e kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja. Të gjithë këta nxënës/e të caktuar në grupet e tyre në bashkëpunim mësojnë njësinë sa më mire, që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'u shpjegojnë nxënësve të tjerë pjesëzën e mësuar. Për të kuptuar sa më mirë pjesën e njësisë

mësimore nxënësit parashtrojnë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon deri sa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Fazën përfundimtare e përmbylлим me stuhi mendimesh, që nxënësit paraprakisht reflektojnë në mënyrë individuale, në çifte e pastaj diskutojnë në grup. Pas përmbledhjes së mendimeve të përbashkëta përfaqësuesi i grupit prezanton idetë kryesore.

Aktivitete shitesë:

Secili grup ka për detyrë të përzgjedhë një zanat dhe të shkruajnë një ese përshkruese për atë zanat. Secili grup e lexon esenë dhe pastaj diskutojnë.

Vlerësimi:

Vlerësimi formativ

Vlerësimi i nxënësve në angazhimin në grup.

Vlerësim individual i nxënësve

27. SHOQËRITË QYTETARE HAPJA E UNIVERSITETEVE DHE ZHVILLIMI KULTUROR

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme

RNSH:Kompetenca I 3; 8. II 2. V 8.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Ilustron aspekte të jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare.
- Shpjegon veçoritë kryesore të feudalizmit dhe arsyet e lindjes së shtresave të reja shoqërore.
- Identifikon shtresat shoqërore, marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe evidenton të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Shoqëri qytetare, shkollim, universitet, shkencë, kulturë

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Letërsi, sociologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Kjo fazë e mësimi zhvillohet në formë të pyetjeve dhe të përgjigjeve me nxënësit. Mësimdhënësi/ja i nxit nxënësit që të përgjigjen në mënyrë individuale, duke i dhënë të drejtë të gjithë nxënësve që të debatojnë për pyetjet që ia parashtron mësimdhënësi/ja në raport me njësinë mësimore. Mësimdhënësi/ja ia parashtron nxënësve këto pyetje: A keni dëgjuar për universitetin e Bolonjës? A keni dëgjuar për universitetin e Oksfordit dhe Kembrixhit? A njihni ndonjë familjar, apo të njohur që i ka përfunduar studimet në këto universitete? Të gjitha përgjigjet që merren, mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë. Nxënësit vazhdojnë të diskutojnë për përgjigjet dhe japin

argumentet e tyre për atë që pajtohen dhe nuk pajtohen me mendime. Pas përfundimit të diskutimit, mësimitdhënësi/ja vazhdon me realizimin e pjesës kryesore të orës.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të zhvillimit të orës mësimore, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ta janë më interesante dhe më të rëndësishme. Pjesa e përzgjedhur dhe numri i faqes shënohen në një fletëz, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për pjesën e përzgjedhur të njësies. P.sh.(Pse e kanë përzgjedhur njësinë që flitet për arsimin, cili është mesazhi, rëndësia etj.). Njëri nga nxënësit e tregon faqen se ku e ka zgjedhur pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit të tjerët diskutojnë rreth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentin e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komenti, nxënësit të tjerë nuk kanë të drejtë të japin komente shtesë. E njëjta ecure e leximit të citatit dhe komentimit praktikohet edhe te nxënës të tjerë.

Pjesa përfundimtare:

Nxënësit së pari ndahen në dyshe, pastaj në grup diskutojnë për pjesën që kanë lexuar, pastaj diskutojnë për informacione të reja dhe më në fund nxjerrin përfundime. Mësimitdhënësi/ja do të angazhojë një anëtar të grupit për të dhënë përfundimet e nxjerra gjatë bashkëbisedimit. Anëtari i grupit mund të përzgjidhet edhe në këtë formë: Nxënësit i vënë lapsat mbi bankë. Mësuesja e bën përzgjedhjen e një lapsi, dhe grupin atëherë e përfaqëson ai nxënës, lapsin e të cilit e përzgjedh mësimitdhënësi/ja.

Aktivitete Shtesë:

Nxënësit lexojnë në mënyrë individuale njësinë mësimore. Pasi të lexojnë, secili grup e bën përzgjedhjen e një nxënësi i cili ka për detyrë që të bëjë intervista në grup në raport me njësinë.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual dhe grupor
Nxënësit vlerësohen për gatishmëri dhe bashkëpunim në grup
Nxënësit vlerësohen në komunikim

28. LUFTËRAT KRYQTARE- KRYQËZATAT

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH:Kompetenca I 1; 6. II 1; 2. III 5.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Përshkruan shkaqet e organizimit dhe rrjedhën e kryqëzatatave si dhe identifikon personazhet kryesore të tyre.
- Identifikon ngulitjet e kryqtarëve (evropianëve) në Lindjen e Afërt dhe rolin e tyre në marrëdhëniet Lindje - Perëndim.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Kryqëzatat, lufta, kulturat, humbjet, rrugët e vjetra, në Iliri, plaçka e luftës

Burimet: Libri, interneti, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja diskuton me nxënësit për kryqëzatat dhe për luftërat kryqtare. Biseda zhvillohet në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve me nxënësit, apo në formë interaktive. Dhënia e ideve mund të jetë në mënyrë individuale, më pas bashkim i ideve në çiftet e në grup. Parashtrihen pyetje, që iu mundësojnë nxënësit të japin përgjigje të ndryshme. Nxënësit nuk duhen të kufizohen në përgjigje. Pyetjet që mund të parashtrihen, P.sh.: Çka janë kryqëzatat? Kush i organizonte? Cili ishte qëllimi i themelimit të tyre? etj.. Mësimdhënësi/ja, apo ndonjë nxënësi që paraqitet vullnetar, të gjitha përgjigjet e nxënësit i shënon në dërrasë të zezë.

Pjesa kryesore:

Të lexuarit në dyshe, apo bashkëpunim, nxënësit u kërkohet që të zgjedhin nga një partner për çift, nga se e gjithë puna do të bëhet në bashkëpunim të çiftëve. Duke i numëruar çiftet (1,2,3,4) secilit çift në klasë i caktohet numri 1 deri 4. Kjo bëhet ngase mësimi është i ndarë në 4 pjesë, dhe secili çift duhet ta mësojë pjesën me numrin përkatës. Çiftet informohen se leximi do të jetë i veçantë, dhe u jepen këto udhëzime: Dy anëtarët e çiftit do të lexojnë në mënyrë individuale gjithë tekstin që i është dhënë. Pastaj, çiftet e ndajnë atë tekst në dy pjesë. Pas leximit, pjesën e parë të tekstit ka për detyrë ta shpjegojë nxënësi A i çiftit, ndërsa anëtari B i bën pyetje A-së për të njëjtën pjesë. Në pjesën e dytë të tekstit, ndërrohen rolet. Nxënësi B është raportues dhe përgjigjedhës,

ndërsa nxënësi A është pyetës. Nxënësit duhet të sigurohen se e kanë mësuar mirë njësinë, sepse më vonë në grupe do të jenë raportues dhe përgjigjedhës. Më pastaj çiftet paraqesin përmbledhjen e pjesës së tyre në fletë transparente, duke filluar nga pjesa e parë e artikullit, nga një çift nga secila pjesë, do të dalë dhe do ta paraqesë përmbledhjen e pjesës së vet para gjithë klasës.

Pjesa përfundimtare

(Pesëvargëshi). Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë (dërrasë të zezë) emrin e temës, apo një emër që ka të bëjë me këtë temë. Meqenëse në këtë njësi mësimore kemi të bëjmë me luftërat kryqtare, dhe qëllimin e krijimit të tyre, atëherë si temë do të marrim temën: „Kryqëzatat” Fjalën kryqëzat mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë, njëjtë veprojnë edhe nxënësit. Nën emër shënohen dy mbiemra, pastaj vazhdojmë me tri folje, një fjali përfundimtare dhe me sinonimin e fjalisë.

1. Kryqëzatat

2. dy mbiemra _____

3. tri folje _____

4. një fjali _____

5. Sinonimi _____

Aktivitete Shtesë:

Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen që të vizatojnë se si duken veshjet e ushtarëve të luftërave kryqtare.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punën individuale

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre

Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimit

29. FRANCA NË SHEKUJT XIV-XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH:Kompetenca I 2. II 2; 8. IV 4; 7.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhojat për shoqërinë evropiane.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalët kyçe: Luftëra, pasoja, Zhan d'Ark, heroin, kryengritje

Burimet: Libri, burime teknologjike, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse

Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore me pyetjet: Çfarë kuptoni me fjalën monarki? A keni dëgjuar ndonjëherë për luftën në mes dy trëndafilave etj. Këto pyetje nxisin kureshtjen te nxënësit për t'u interesuar se çka do të mësohet në pjesën vijuese të orës.

Pjesa kryesore:

Më pas do të vazhdojmë me teknikën *DLTA* ku mësimdhënësi/ja ju drejtohet nxënësve me udhëzimet për të dëgjuar me vëmendje pasi ata do të përgjigjen në pyetjet që do parashtrojnë pas çdo ndalese. Meqë njësia mësimore përbëhet nga katër nëntituj atëherë mësimdhënësi/ja njësinë mund ta ndajë në katër pjesë, apo pas çdo përfundimi të nëntitullit (pjesës) u parashtrojnë pyetje në lidhje me atë se çfarë kanë dëgjuar dhe çfarë mendimi kanë lidhur me pjesën që pason në tekst. Tekstin mund ta lexojë vetë mësimdhënësi/ja apo të kërkojë nga ndonjë nxënës i cili lexon bukur dhe rrjedhshëm. Njësinë mësimore e ndanë në këto pjesë: Franca në prag të luftërave me Anglinë. Lufta 100-vjeçare në mes Francës dhe Anglisë dhe pasojat e saj. Zhana D'Ark heroina franceze. Kush ishin zhakët, kryengritës në Francë.

Pyetjet që mund t'i parashtrohen nxënësve pas ndalesave, p.sh. Pse u zhvillua lufta në mes të Francës dhe Anglisë? Kush kishte të drejtë? Në çka bazoheni? Kush ishte Zhan D'ark? Cilat ishin sukseset e saj? çfarë ndodhi me Zhan D'ark? etj., kështu vazhdohet me të gjitha pjesët e njësisë mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë mund të përmbyllim me teknikën *Mendo/puno në dyshe/shkëmbe*, ku mësime dhënësi/ja mund të japë një detyrë që duhet të kryejnë në mënyrë individuale, më pas në dyshe dhe në fund do të shkëmbejnë mendimet e tyre me tërë grupin. Pasi të bashkojnë idetë, detyrat e tyre mund të lexohen në klasë.

Aktivitetet shpesh:

Mësime dhënësi/ja udhëzon nxënësit që të përgatisin projekte duke integruar mediet (kompjuterin, Tv, Radio, Telefon, DVD) për të paraqitur jetën e Zhan D'ark-ut, nxënësit e tjerë kanë mundësi të paraqesin jetën e ndonjë femre shqiptare (Nora e Kelmendit), që ka kontribuar për çështjen kombëtare.

Vlerësimi:

Vlerësim formativ

Nxënësit vlerësohen për angazhim në grup

Nxënësit vlerësohen për cilësi të prezantimeve.

30. ANGLIA NË SHEKUJT XIV-XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.

RNSH: Kompetenca I 1; 4. II 7. IV 7. VI 2.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhojat për shoqërinë evropiane.
- Analizon rrethanat e krijimit dhe ndikimet e Magna Carta-s në jetën dhe sistemin juridik mesjetar.
- Identifikon shtresat shoqërore, marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe evidenton të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalët kyçe: Pushtet, absolut, Karta e Lirive, parlament, trëndafil.

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Ed.Qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse

Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore me pyetjet: Çfarë kuptoni me fjalën monarki? A keni dëgjuar ndonjëherë për luftën në mes dy trëndafilave, Ç'do të thonë për ju të drejtat dhe liritë e njeriut etj. Këto pyetje nxisin kureshtjen te nxënësit për t'u interesuar se çka do të mësohet në pjesën vijuese të orës.

Pjesa kryesore:

Më pas do të vazhdojmë me teknikën *DRTA* ku mësimdhënësi/ja u drejtohet nxënësve me udhëzimet për të lexuar me vëmendje pasi ata do të përgjigjen në pyetjet që do parashtron pas çdo ndalesë. Meqë njësia mësimore përbëhet nga tre nëntituj, atëherë mësimdhënësi/ja njësinë mund ta ndajë në tri pjesë, apo pas çdo përfundimi të nëntitullit (pjesës) u parashtron pyetje në lidhje me atë se çfarë kanë dëgjuar dhe çfarë mendimi kanë lidhur me pjesën që pason në tekst. Tekstin do ta lexojnë vetë nxënësit. Njësinë mësimore e ndan sipas nëntitujve të njësisë mësimore: Çka ishte Karta e Madhe e Lirive. Formimi i Parlamentit anglez. Trëndafili i kuq dhe i bardhë dhe lufta midis tyre

Pyetjet që mund t'i parashtrohen nxënësve pas ndalesës së parë, p.sh. Çka nënkuptoni me Kartën e Lirive? Cila ishte përmbajtja e saj? Pas ndalesës së dytë: Çfarë do të thotë formimi i parlamentit? Në çka bazoheni? Pas ndalesës së tretë: Kush ishin trëndafilat e bardhë? Po të kuqtë? Çfarë mendoni se do të ndodhë? Cilat argumente mund të ofroni? etj. Pastaj, kështu vazhdohet me të gjitha pjesët e tjera të njësisë mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë mund të përmbylлим me teknikën *Mendo/puno në dyshe/shkëmbe*, ku mësimdhënësi/ja mund të japë një detyrë që duhet të kryejnë në mënyrë individuale, më pas në dyshe dhe në fund do të shkëmbejnë mendimet e tyre me tërë grupin. Pasi të bashkojnë idetë, detyrat e tyre mund të lexohen në klasë.

Aktivitete Shtesë:

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të përgatisin projekte duke integruar mediet (kompjuterin, Tv, Radio, Telefon, DVD) për të paraqitur luftën në mes të dy trëndafilave.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për angazhim në grup.

Hulumtime individuale.

Nxënësit vlerësohen për cilësi të prezantimeve.

31. GJERMANIA GJATË SHEKUJVE XI-XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.

RNSH: Kompetenca I 2; 4; 6. II 8. III 5.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon veçoritë kryesore të feudalizmit dhe arsytet e lindjes së shtresave të reja shoqërore.
- Shpjegon rolin e avancimit të zejtarisë dhe tregtisë në lindjen e formave të reja të organizimit të grupeve të interesit (esnafet, gildet, hanzat etj.) në shoqërinë mesjetare.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalët kyçe: Bujqësia, blegtoaria, zejtaria, dinastia Shtaufen, perandor.

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Biologji, ekonomi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Për këtë njësi mësimore mund të përdoret teknika *Copëzat e përziera*. Mësimdhënësi në planifikimin e tij të kësaj teme ka të përgatitur me dhjetëra fjalë në copëza letre të cilat i ka sjellë me vete në klasë. Këto copëza janë me fjalë që kanë të bëjnë me njësinë mësimore si p.sh. Gjermania, feudal, rendi shoqëror, martesë, ekonomi, zejtar, tregti, mbret, Henriku, Ferdinandi, etj. Copëzat u shpërndahen grupeve të nxënësve që janë të përbëra nga 4 -5 veta, dhe udhëzohen t'i renditin duke formuluar fjali me kuptim.

Pjesa kryesore:

Gjatë kësaj faze të orës mësimore mësimdhënësi/ja mund të përdorë teknikën *Procedura e të Pyeturit*. Sipas kësaj teknike nxënësit punojnë në çifte, dhe udhëzohen të lexojnë tekstin në mënyrë individuale, por ndalen në fund të çdo paragrafi dhe pyesin njëri-tjetrin me radhë të reflektojnë për atë çfarë kanë kuptuar dhe japin sqarime argumentuese pse mendojnë ashtu. Kjo zgjat derisa të përfundojnë tërë njësinë mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Pasi të përfundojnë do të diskutojnë në grup për të shkëmbyer idetë mes tyre, pas pesë minutave përmbledhjen e ideve do ta prezantojnë për tërë klasën. Mësimdhënësi do të shënojë të gjitha mendimet e nxënësve në tabelë, ndërsa nxënësit shënojnë gjërat e reja që mësuuan gjatë leximit. Rëndësia është se nxënësit janë të përqendruar në procesin e të lexuarit duke shënuar çdo informacion që u nevojitet.

Aktivitete Shtesë:

Nxënësit diskutojnë për zhvillimet shoqërore në Gjermani.

Vlerësimi:

Vlerësim i vazhdueshëm

Vlerësim për kulturë të diskutimit

Në pjesëmarrje, në diskutim.

32. ITALIA NË SHEKUJT XI-XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.

RNSH:Kompetenca I 2; 4, 6.
II 8. III 5; 6.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhojat për shoqërinë evropiane.
- Shpjegon rolin e avancimit të zejtarisë dhe tregtisë në lindjen e formave të reja të organizimit të grupeve të interesit (esnafet, gildet, hanzat etj.) në shoqërinë mesjetare.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Italia, Venediku, Papati, Piza etj.

Burimet: Libri, internet, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi në mes të tabelës formon një rreth dhe në mes të tij shkruan Italia. Të njëjtën gjë kërkon edhe nga nxënësit të bëjnë në fletoret e tyre. Nxënësit do të shkruajnë në fletoret e tyre krejt çfarë mendojnë se dinë për Italinë, por vetëm në formë fjale. Pas tre minutave mësimdhënësi/ja kërkon të reflektojë për atë se çfarë kanë shkruar në fletoret e tyre dhe ai shënon idetë e tyre në tabelë. p.sh.:

	Italia	

Pjesa kryesore:

Në vijim mësimdhënësi/ja përmbajtjen mësimore e zhvillon përmes *Leksionit të avancuar*. Ndan klasën në grupe me numër çift dhe ua shpjegon detyrën ta punojnë sipas udhëzimeve që u jep. Një nxënës i çiftit shkruan përputhjet e ideve të leksionit me ato të shkruara në tabelë dhe vendos shenjën + që pohon idetë, - kundërshton idetë, ndërsa nxënësi tjetër i çiftit shkruan ndonjë ide që atij i duket interesante nga tema që mësojnë. Në mbarim të pjesës së parë bëhen diskutime dhe krahasime të çifteve, por edhe të grupit në tërësi. Pastaj për të përvetësuar më mirë njësinë i bëjnë pyetje njëri-tjetrit. Procedura vazhdon me të gjitha grupet gjer në përfundimin e njësisë, e më pas diskutohen idetë në klasë.

Pjesa përfundimtare:

Në fund bëhet një përmbledhje e informacioneve të njësisë përmes një eseje, dhjetë minuta, dhe lexohet para klasës. Leximi i esesë bëhet në baza vullnetare.

Aktivitete shtesë:

Udhëzohen nxënësit të hulumtojnë në internet për vendet që kanë lënë gjurmë në periudha të ndryshme historike. P.sh. mund të ndahen në grupe hulumtuese të cilat më pas do prezantojnë punimet e tyre. Italia, Roma (Vatikani), Venediku, Napoli etj.

Vlerësimi:

Vlerësimi i vazhdueshëm

Vlerësim në bashkëpunim në grup

Vlerësim individual

Nxënësit vlerësohen për hulumtime dhe prezantime.

33. PERSONALITETE TË SHQUARA TË HISTORISË SË MESJETËS

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH:Kompetenca I 2; 3; 4. IV 3. VI 1.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon personalitetet më të spikatura nga fusha e artit, kulturës, shkencës, teknologjisë e politikës, në Mesjetë, dhe vlerëson veprimtarinë e kontributin e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Justiniani, Marko Pollo, Xhingis Kan, Zhan D'ark etj.

Burimet: Libri, foto, interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimsdhënësi/ja përdor teknologji mësimore (projektorin) për të prezantuar personalitetet më të shquara të historisë së Mesjetës, si: Justinianin, Zhan D'ark-un, Eduardin III, Sulltan Mehmetin II, Marko Pollon, Xhingis Kanin. A dini ndonjë figurë të shquar shqiptare gjatë mesjetës? Skënderbeu, Balsha II, Karl Topia, etj.. Për çka njiheshin personalitetet që i cekët, cila ishte veprimtaria e tyre? Cilat janë anët e mira të veprave të tyre për shoqërinë e asaj kohe? etj.

Pjesa kryesore:

Gjatë pjesës kryesore të orës mësimore, nxënësit këshillohen të lexojnë në heshtje një pjesë të njësisë mësimore apo për personalitetin që i është përzgjedhur apo caktuar. Nxënësit/et udhëzohen të mbajnë shënime për atë çfarë lexojnë. Pasi të përfundojnë diskutojnë për përmbajtjen, në çifte e më pas në grup, kështu do të zhvillohet një nxënie në bashkëpunim, dhe do të renditin idetë në harmoni të grupit.

Pjesa përfundimtare:

Në përmbyllje me teknikën *Turi i Galerisë*, nxënësit udhëzohen të punojnë një pikturë, shkrim të lirë apo sipas vullnetit të tyre një aktivitet që është në lidhje me temën. Pasi të përfundohet, punimet vendosen në muret e klasës, pastaj nxënësit me radhë shkojnë dhe i shikojnë punimet, diskutojnë dhe mund të plotësojnë me ndonjë ide duke shkruar në punimet e grupevetë tjera,

të shkruajnë ndonjë koment etj.. Në fund grupet marrin punimet e tyre, rishikojnë, krahasojnë me punimet e tjera, lexojnë komentet e marra nga të tjerët etj.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit diskutojnë për personalitetet e ndryshme dhe analizojnë ngjashmëritë e tyre me një personalitet tjetër të shquar.

Vlerësimi:

Vlerësimi i vazhdueshëm

Vlerësim individual

Vlerësim në grup

VI. FORMIMI I PERANDORISË OSMANE DHE PUSHTIMET NË BALLKAN

34. PERANDORIA OSMANE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH: Kompetenca I 3. II 1; 4. V 1, 8.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhjat për shoqërinë evropiane.
- Përshkruan fillet e shtetit osman dhe zgjerimin e tij.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Osmane, perandori, ballkan, pushtim, sulltan, spahi, jeniçer

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës përdorin teknikën *Kllasteri* apo *pema e mendimit*. Mësimdhënësi i nxit nxënësit që të mendojnë lirshëm se çfarë dinë për temën, Perandoria Osmane. Nxënësit në mes të fletores e shkruajnë Perandoria Osmane duke krijuar një degëzim rreth asaj se ç' dinë për Perandorinë osmane. Ky aktivitet zhvillohet në dyshe. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve i shkruan në tabelë dhe bën një degëzim sipas rendit logjik.

Pjesa kryesore:

Në vazhdim, mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin në mënyrë individuale duke vendos shenjat: Shenja $\sqrt{}$ (tik) informacion i cili njihet nga nxënësit, Shenja – (minus) informacion i cili është i ndryshëm nga informacioni që ka pas më parë, Shenja + (plus) informacion i ri, dhe shenja ? (pikëpyetje) informacion i paqartë për nxënësin. Gjatë kohës që lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas plotësojnë tabelën sipas udhëzimeve të mësimdhënësit.

	√	-	+	?	

Pjesa përfundimtare:

Në përmbyllje me teknikën *Turi i Galerisë*, nxënësit udhëzohen të punojnë në reflektim një shkrim të lirë sipas vullnetit të tyre, në lidhje me temën. Pasi të përfundojnë, punimet vendosen në muret e klasës, pastaj nxënësit me radhë shkojnë dhe i shikojnë punimet, diskutojnë dhe mund të plotësojnë me ndonjë ide duke shkruar në punimet e grupeve të tjera, të shkruajnë ndonjë koment etj. Në fund grupet marrin punimet e tyre, rishikojnë, krahasojnë me punimet e tjera, lexojnë komentet e marra nga të tjerët etj.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit debatojnë për Perandorinë Osmane dhe Turqinë e sotme. Përzgjidhet një nxënës/e që do ta udhëheqë debatin.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen sipas bashkëpunimit në grup,
Në punë individuale
Në kulturën debatuuese

35. BETEJA E MARICËS DHE BETEJA E KOSOVËS

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH:Kompetenca I 3. II 1; 2. III 7. IV 4.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon gjendjen politike në Ballkanit në prag të pushtimeve osmane.
- Krahason të dhëna të ndryshme për Betejën e Kosovës, vlerëson bashkëpunimin midis popujve të Ballkanit, si dhe argumenton pasojat që pati kjo betejë për ta.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe:Pushtim, betejë, Maricë, Kosovës, koalicion, perandori, sulltan.

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të evokimit mund të përdoret teknika parashikim nëpërmjet fjalëve kyçe. Kjo teknikë është e përshtatshme për lidhjen emocionale të nxënësit më njësinë e re mësimore. Ecuria është: Caktohen katër-pesë fjalë që përdoren brenda mësimit dhe që i bën kureshtarë nxënësit për përmbajtjen e njësies së re. Fjalët kyçe të mësimit janë: Gazimestan, Millosh Kopiliqi, Sulltan Murati, Forcat osmane, forcat e bashkuara ballkanike. Me këto fjalë kyçe nxënësit thurin një ngjarje. Më pas nxënësit në dyshe shkëmbejnë ngjarjet e thurura, apo lexohen disa nga këto krijime të nxënësve para gjithë klasës.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të mësimit, mësuesi/ja i tregon nxënësve se çka do të lexojnë, dhe gjatë leximit ata do të marrin shënime. Më pas u tregohet që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale. Më pas gjatë leximit, në të majtë të faqes shkruajnë ndonjë mesazh apo citat nga teksti. (pjesa që u bën përshtypje), ndërsa në anën e djathtë duhet të shkruhen komentet: Pse jeni përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri përshtypje? Çfarë pyetjesh keni? (komenti përse ju bëri përshtypje). Të njëjtin lexim e bën edhe mësimdhënësi/ja. Në fund të leximit kërkohen vullnetarë (2-3 veta) që të japin komentet e tyre. Pas leximit të pjesës që u ka bërë përshtypje, vullnetarët pyetën: Pse ju tërhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çka ju bëri të mendoni? Pyetet nëse ka ndonjë tjetër që e ka zgjedhur të njëjtën pjesë. Pyetet: A ka ndonjë arsye tjetër që e ka zgjedhur atë pjesë.

Në fund shtrohen pyetjet: Çfarë do të mbani mend nga ky material?, Cili është mesazhi më i rëndësishëm?

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë mësimdhënësi/ja mund t'i japë nxënësve një pyetje. Pyetjes gjithherë duhet t'i shtohet edhe pjesa që kërkon argumentin e çështjes. P.sh. Cilat ngjarje po ju duken të çuditshme, për kohën e sotit? Arsyeto pse janë të çuditshme. Disa nga këto shkrime lexohen dhe diskutohen.

Aktivitete shitesë:

Grupet e nxënësve përgatitin nga tri pyetje për grupet e tjera. Grupet përzgjedhin udhëheqësin e grupit, i cili ka për detyrë të prezantojë grupin.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen sipas bashkëpunimit në grup,
Në punë individuale
Në kulturën debatusese

VII. ARBËRIA GJATË SHEKULLIT XV

36. SHOQËRIA SHQIPTARE GJATË SHEKUJVE XIV-XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme

RNSH:Kompetenca II 6. IV 2; 5. VI 2; 7.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon shtresat shoqërore, marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe evidencon të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Fisnik, despot, princ, zhupan, vojvodë, ndarje, trashëgimi, martesë

Burimet: Libri, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në fillim të orës, mësime nxënësi/ja për të bërë lidhjen emocionale të nxënësve me njësinë e re që do të mësohet, përcakton katër terma, apo fjalë kyçe që përdoren shpesh brenda njësisë mësimore. Pasi që të përcaktohen termat apo fjalët kyçe të mësimit, nxënësve u kërkohet që për 5 minuta të thurin një ngjarje me këto fjalë kyçe: Fisnikëria, ndarja e drejtë, trashëgimia, martesat etj. Pasi që të shkruajnë, nxënësit shkëmbejnë ngjarjet e thurura, dhe pastaj lexohen disa nga këto krijime të nxënësve para gjithë klasës.

Pjesa kryesore:

Në vijim do të kërkohet nga nxënësit të ndahen në tri grupe dhe secili grup lexon në mënyrë individuale njësinë e ndarë në paragrafë. Njësia ndahet në këto paragrafë, apo pjesë: 1) Fisnikëria, 2.) Ndarja e drejtësisë, trashëgimia dhe bashkëqeverisja, si dhe 3.) Martesat.

Pas leximit të pjesës, nxënësit do të bashkëbisedojnë në çifte, e më pas së bashku me tërë klasën do të reflektojnë për atë çfarë kanë nxënë.

Pasi të reflektojnë mësuesi mund të parashtojë pyetje, siç: Cili është roli i fisnikërisë shqiptare që nga shekulli XI?, Na thoni disa emra të fisnikëve., A e respektonin legjislacionin e pushtetit territoret arbërore?, Kush vendoste për fatin e femrave dhe të djemve në shoqërinë shqiptare të shekullit XIV dhe XV?, Për çfarë interesash lidheshin martesat në shekullin e XIV dhe XV?, etj.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë të orës mësimore do të kërkohet nga nxënësit të reflektojnë në mënyrë individuale. Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen që të shkruajnë një shkrim të lirë rreth njësisë mësimore. Pasi të përfundojnë kërkohet nga të gjithë të paraqesin atë se çfarë kanë mësuar gjatë kësaj ore mësimore. Mësuesi shënon disa nga idetë e nxënësve në tabelë pasi që e gjithë kjo ndihmon në të nxënësit në bashkëpunim.

Aktivitetet shpesh:

Secili grup ka për detyrë të përzgjedhë një përfaqësues të grupit. Anëtarët e grupit në bashkëpunim udhëzohen që të shkruajnë për temën: „Të drejtat e femrave sot”. Pasi që të shkruajnë, udhëheqësit e grupeve prezantojnë para grupeve të tjera temën të cilën e kanë përgatitur.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunim në grup

Nxënësit vlerësohen për aktivizimin gjatë punës në grup

Nxënësit vlerësohen për aftësinë e prezantimit të detyrave të dhëna si në grup ashtu edhe në mënyrë individuale.

37. PUSHTIMET E VENEDIKUT NË SHQIPËRI GJATË SHEKUJVE XIV-XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH: Kompetenca I. 3. II 1; 4. V 1; 8.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhojat për shoqërinë evropiane.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Pushtim, venedikas, koalicion

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët tjera e mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, arti pamor.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi fillon orën me pyetjet: Cilat janë portet detare në Shqipëri, dhe ku gjenden ato? Çfarë rëndësie kanë portet detare në qytetet shqiptare? Këto pyetje nxitin kureshtjen te nxënësit për t'u interesuar se për çfarë do të mësohet gjatë kësaj ore mësimore. Mësimdhënësi/ja të gjitha përgjigjet e nxënësve i shënon në tabelë.

Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin në mënyrë individuale duke vendos shenjat: Shenja √ (tik) informacion i cili njihet nga nxënësit, Shenja – (minus) informacion i cili është i ndryshëm nga informacioni që ka pas më parë, Shenja + (plus) informacion i ri dhe shenja? (pikëpyetje) informacion i paqartë për nxënësin. Gjatë kohës që lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas plotësojnë tabelën sipas udhëzimeve.

	√	-	+	?	

Pjesa përfundimtare:

Në fazën përmbyllëse, nxënësve u kërkohet që fleta e fletores të ndahet në mes me një vijë vertikale. Më pastaj të fillojë të lexojnë njësinë, dhe në të majtë të faqes shkruajnë ndonjë mesazh apo citat nga teksti p.sh. (pjesa që u bën përshtypje), ndërsa në anën e djathtë duhet të shkruhen komentet: P.sh.: Pse jeni përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri përshtypje? Çfarë pyetjesh keni? Të njëjtin lexim e bën edhe mësimdhënësi/ja. Në fund të leximit kërkohen vullnetarë (2-3 veta) që të japin komentet e tyre. Pas leximit të pjesës që u ka bërë përshtypje, vullnetarët pyetën: Pse u tërhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çka u bëri të mendoni? Shtrohet pyetja: A ka ndonjë nxënës tjetër që e ka zgjedhur të njëjtën pjesë? A ka ndonjë arsye tjetër që e keni përzgjedhur këtë pjesë etj. Në fund, mësimdhënësi/ja jep komentet e saj /tij të nxjerra gjatë leximit që ai/ajo ka bërë. Në fund shtrohen pyetjet: Çfarë do të mbani mend nga ky material?, Cili është mesazhi më i rëndësishëm?. Këtyre pyetjeve, nxënësit u japin përgjigje në formë *brainstorming*.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit duke bashkëpunuar në grup analizojnë dhe shpjegojnë arsyet e pushtimit të tokave shqiptare nga Venediku.

Vlerësimi:

Vlerësim formativ

Vlerësim në aktivitete individuale dhe në bashkëpunim

Vlerësim në komunikim

38. PRINCIPATA E KASTRIOTËVE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH:Kompetenca I 1; 4. II 7. IV 7.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Veçon përfaqësues të dalluar të bujarisë arbërore, faktorët që ndikuan në fuqizimin e tyre, përkufizon principatat e veçanta dhe marrëdhëniet midis tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Kastriotët, familje, zgjerim, territor

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, gjeografi, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Për të bërë lidhjen emocionale të nxënësve me njësinë e re mësimore, mësimdhënësi/ja cakton katër terma që përdoren shpesh në këtë njësi, apo janë fjalë kyçe të kësaj njësie mësimore. Fjalët kyçe të kësaj njësie janë: Familja e Kastriotëve, Gjoni, Gjergji, Vojsava, shekulli XIV-XV .Nga këto fjalë nxënësit për 5-10 minuta thurin një ngjarje, ku përfshihen këto pesë terma. Më pas nxënësit në dyshe shkëmbejnë ngjarjet e thurura dhe lexojnë shkrimet e tyre para klasës. Pa ashtu mësimdhënësi/ja u jep hapësirë nxënësve për të diskutuar.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të lexojnë njësinë mësimore. Njësia mësimore është e ndarë në tre nëntituj: Kush ishin Kastriotët, Familja e Kastriotëve formojnë principatën e tyre, si dhe Shtrirja territoriale e Principatës së Gjon Kastriotit. Leximi bëhet në mënyrë individuale. Nxënësit lexojnë vetëm pjesën e parë dhe mbyllin tekstin. Pas leximit të pjesës së parë, nxënësve u parashtrohen pyetje: p.sh. Kush ishin Kastriotët, Si quhej gjyshi i Skënderbeut etj.

Pas përfundimit të pjesës së parë, nxënësit vazhdojnë të lexojnë pjesën e dytë të njësisë mësimore Familja e Kastriotëve formojnë principatën e tyre. Pasi të përfundojnë leximin mësimdhënësi/ja parashtron pyetje për familjen e Kastriotëve, dhe principatën e tyre. Pse Principata e Kastriotëve filloi ta fuqizojë veprimtarinë politike të vet në viset perëndimore?

Pastaj vazhdojnë të lexojnë pjesën e tretë të njësisë mësimore, Shtrirja territoriale e Principatës së Gjon Kastriotit. Pasi të lexojnë këtë paragraf, apo pjesë, mësimdhënësi/ja i parashtron disa pyetje nxënësve: Çfarë bëri Gjoni për të nxitur sa më shumë ardhjen e tregtarëve të huaj në vendin e tij ? Në cilin vit Gjoni arriti të merrte Ulqinin, e ma vonë Shëngjinin? etj. Përveç mësimdhënësit/ës që parashtron pyetje, edhe nxënësit nxiten t'i parashtrojnë pyetje njëri-tjetrit, apo më një fjalë të zhvillohet një nxënie interaktive.

Pjesa përfundimtare:

Nxënësit së pari ndahen në dyshe, pastaj në grup diskutojnë për pjesën që kanë lexuar, pastaj diskutojnë për informacione të reja dhe më në fund nxjerrin përfundime. Mësimdhënësi/ja do të angazhojë një anëtar të grupit për të dhënë përfundimet e nxjerra gjatë bashkëbisedimit. Anëtari i grupit mund të përzgjidhet edhe në këtë formë: Nxënësit i vënë lapsat mbi bankë. Mësimdhënësi/ja i/e bën përzgjedhjen e një lapsi, pastaj grupin do të përfaqësojë pronari i lapsit.

Aktivite shtesë:

Nxënësit lexojnë në mënyrë individuale njësinë mësimore. Pasi të lexojnë, secili grup e bën përzgjedhjen e një nxënësi i cili ka për detyrë që të bëjë intervista në grup në raport me njësinë.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual dhe grupor

Nxënësit vlerësohen në shkathtësi të komunikimit

Nxënësit vlerësohen në mënyrë permanente

39. MARRJA E FËMIJËVE PENG DHE REKRUTIMI I TYRE NË USHTRINË OSMANE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

RNSH:Kompetenca I 2; 3. II 1; 2.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Analizon pozitën vasale të princave ballkanas ndaj Perandorisë Osmane dhe nxjerr përfundime për gjendjen e popujve të Ballkanit.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Administratë, organizim, pengmarrje, rekrutim, harraq.

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, jurispodencë

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të mendohen dhe të tregojnë se a kanë dëgjuar ndonjëherë fjalën rekrutim? Ç’është rekrutimi. Kush e ka bërë dhe pse kanë rekrutuar? Nxënësit japin idetë e tyre, pa iu kufizuar mendimi. Të gjitha idetë e tyre shkruhen në tabele, më pastaj vazhdon bashkëbisedimi për marrjen peng dhe rekrutimin e fëmijëve.

Pjesa kryesore:

Ruaje fjalën e fundit për mua; Përmes kësaj teknike, nxënësit udhëzohen që të lexojnë komplet njësinë mësimore, më pastaj të përcaktohen për njësinë që kanë përzgjedhur, që për ta është më interesante. Pjesët e zgjedhura dhe numri i faqes ku është marrë pjesa shkruhen në një fletëz, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për citatin pse e ka zgjedhur atë pjesë, cili është mesazhi, rëndësia etj. Njëri nga nxënësit e tregon faqen ku e ka zgjedhur pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit të tjerët diskutojnë rreth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për një pjesë lexon komentimin e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komenti, nxënësit e tjerë nuk kanë të drejtë të japin komente shtesë. E njëjta ecuri e leximit të citatit, dhe komentimit praktikohet edhe te nxënësit e tjerë.

Pjesa përfundimtare:

Pasi të kenë përfunduar, mësimdhënësi/ja, kërkon nga nxënësit që të paraqesë përmes vizatimit, komentit, pjesëzën e mësuar. Pasi të kenë vizatuar, fletët e tyre mund të bëhen në formë të posterit dhe të vihen në mure të klasës.

Aktivitete shitesë:

Nxënësve u kërkohet të përzgjidhet një përfaqësues i grupit i cili ka për detyrë të bëjë intervistë me temën: Rekrutimit i fëmijëve të marrë peng në shtetin osman.

Nxënësit vlerësohen për punën individuale

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në grup

Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimeve

40. FAMILJA, FËMIJËRIA DHE RINIA E HERSHME E GJERGJ KASTRIOTIT

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH:Kompetenca I 2. II 2; 6. III 3; 6.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon veçoritë kryesore të personalitetit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut si strateg dhe burrë shteti.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Familje, fëmijëri, shkollim, qeverisje

Burimet: Libri, foto, interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, teknologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që për 10-15 të shkruajnë një ese me temën: „Rinia e hershme e Gjergj Kastriotit”. Nxënësit pasi që të shkruajnë, kërkohet që ndonjëri prej tyre të lexojë temën. Nxënësit e tjerë kanë mundësi të bëjnë pyetje të ndryshme dhe të diskutojnë për temën.

Pjesa kryesore:

Nxënësit ndahen në grupe, me nga tre anëtarë. Brenda grupeve numërohen: 1,2,3, në mënyrë që secili grup të ketë nga tre anëtarë, prej 1 deri në 3. Meqë numri i nxënësve është më i madh mund të dyfishohen numrat e përcaktuar, kjo vetëm ndihmon që grupi i ekspertëve të zotërojnë më mirë pjesëzën e tyre. Nxënësit njoftohen për mësimin që do ta mësojnë. Mësimdhënësi/ja shënon në tabelë temën mësimore që do të zhvillojnë. Nxënësit/et njoftohen se njësia mësimore është e ndarë në tri pjesë:

- 1.) Familja dhe fëmijëria e Gjergjit;
- 2.) Shkollimi i Gjergjit
- 3.) Gjergj Kastrioti-Skënderbeu-qeveritar i Krujës

Nxënësit që kanë numrin 1 janë përgjegjës të mësojnë për *familjen dhe fëmijërinë e Gjergjit*, nxënësit që kanë numrin 2 janë përgjegjës të mësojnë për pjesën e njësishë *Shkollimi i Gjergjit*,

dhe nxënësit që kanë numrin 3 janë përgjegjës të mësojnë për *Gjergj Kastriotin-qeveritar i Krujës*. Qëllimi përfundimtar është që secili nxënës t'i mësojë të tri pjesët e njësisë. Pas leximit të pjesës së njësisë, nxënësit që kanë numrin 1 ulen së bashku, nxënësit me numër 2 po ashtu ulen bashkë e kështu me radhë deri në numrin tre. Nxënësit njoftohen se grupet e formuara tani quhen grupe ekspertësh, ndërsa grupet fillestare quhen grupe familjare apo të bashkëpunimit. Grupet e ekspertëve duhet të dinë se pas mësimi të pjesës do të kthehen në grupe familjare dhe atje do t'ua shpjegojnë anëtarëve të tjerë të grupit pjesën që kanë mësuar. Gjatë shpjegimit ata duhet të sigurohen se të gjithë anëtarët e grupit e kanë kuptuar njësinë në tërësi. Kjo teknikë pune krijon vetëbesim, përgjegjësinë individuale dhe kolektive **te nxënësit**.

Pjesa përfundimtare:

(Pesëvargëshi). Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë emrin e temës, apo një emër që ka të bëjë me këtë temë. Meqenëse në këtë njësi kemi të bëjmë me familjen dhe fëmijërinë e hershme të Skënderbeut, atëherë marrim vetëm fjalën *Skënderbeu*. Fjalën *Skënderbeu* e shkruajmë në tabelë, njëjtë veprojnë edhe nxënësit, pastaj vazhdojmë: Nën emër nxënësit përzgjedhin dy mbiemra, tri folje vazhdojmë me tri folje, një fjali përfundimtare dhe sinonimin e fjalisë.

SKËNDERBEU

2. Dy mbiemra _____

3. Tri folje _____

4. Një fjali _____

5. Sinonimi i fjalisë _____

Aktivitete shtesë:

Nxënësit/et. së bashku me mësimdhënësin/ën shikojnë ndonjë film në klasë për jetën dhe luftërat e Skënderbeut. Pasi që të shikojnë mund të diskutojnë për personazhet, dhe për anët pozitive dhe negative të filmit.

Vlerësimi:

Vlerësohen për interesimin dhe kureshtjen për të shikuar filmin.

Vlerësohen për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në diskutim

Vlerësohen për respektin që kanë për të tjerët.

41. KRYENGRITJA E VITIT 1443 DHE KTHIMI I GJERGJ KASTRIOTIT NË KRUJË

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.	RNSH: Kompetenca I 2. II 1; 2. V 3.
---	--

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhojat për shoqërinë evropiane.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Pushtime, hungarez, fisnik, Gjergj Kastrioti- Skënderbeu

Burimet: Libri, foto, interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:


Këtë fazë të orës mësimore e fillojmë me *brainstorming* duke kërkuar nga nxënësit që të flasin lirshëm për *Rrugëtimin e Skënderbeut dhe kthimin e tij në Krujë*. Pasi të marrim disa ide të nxënësve, mësimdhënësi/ja vazhdon me pyetjen tjetër. Kush ishte Junash Huniadi? etj. Të gjitha përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.

Pjesa kryesore:

Nxënësit lexojnë në mënyrë individuale tërë njësinë mësimore. Pasi lexojnë, diskutojnë në çifte e më pas në grup duke shkëmbyer njohuritë që kanë përfutur nga leximi. Më pas përgatisin një përmbledhje të asaj çfarë kanë mësuar dhe reflektojnë para klasës.

Pjesa përfundimtare:

Mësimdhënësi/ja në mes të tabelës e shkruan: *Kthimi i Skënderbeut në Krujë*, më pastaj udhëzon nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë në fletoret e tyre. Më pas nxënësit në mënyrë individuale vizatojnë një kllaster pastaj udhëzohen të bashkëpunojnë në dyshe dhe në grup, duke degëzuar sa më shumë kllasterin me ide të ndryshme nga njëri-tjetri.

**Aktivitete shitesë:**

Hulumtoni në internet për temën: Çfarë thonë të huajt për figurën e Skënderbeut.

Vlerësimi:

Vlerësimi i vazhdueshëm

Vlerësim për pjesëmarrje në diskutim

Vlerësim individual në punë hulumtuese

42. FORMIMI I SHTETIT SHQIPTAR-LIDHJA E LEZHËS 2 MARS 1444

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.

RNSH:Kompetenca I 2; 6. II 2. III 3. IV 7.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Vlerëson rolin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në themelimin e Lidhjes së Lezhës dhe analizon përpyjekjet e tij për formimin e shtetit arbëror.
- Identifikon shtresat shoqërore, marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe evidenton të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Kuvend, fisnik, bisedime, rekrutim, ushtri

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:, Gjeografi, ed.qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Fillimin e orës mësimore, mësimsdhënësi/ja e zhvillon në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve me nxënësit. Mësimsdhënësi/ja parashtron pyetje të ndryshme, gjë që nxënësit mund të përgjigjen në mënyrë individuale, gjithashtu edhe në çifte. Nxënësit iu parashtrohen këto pyetje: Skënderbeu, pas kthimit në Krujë, çfarë bisedoi me princin e feudalë shqiptarë? Sipas Skënderbeut, cila ishte mënyra më e mirë për t'i bërë ballë Perandorisë Osmane? Cila ishte arsyeja e mbajtjes së Kuvendit ? Kur u vendos të mbahet Kuvendi dhe në cilin qytet? Nxënësit kanë mundësi të japin përgjigje të ndryshme, dhe nuk duhet të kufizohen në përgjigje. Përmes kësaj teknike, nxënësit mund të nxjerrin konstatime e ide për njësinë e mësuar.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit lexojnë në mënyrë individuale njësinë mësimore dhe mbajnë shënime për të plotësuar tabelën rreth informatave që marrin gjatë leximit. Pasi të kenë

përfunduar bashkëbisedojnë në grup për të reflektuar për informacionet e ndryshme që hasin në tekst.

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit/et për atë se çka do të lexojnë. Pastaj tabelën (dërrasën e zezë) e ndan në tri kolona: Në kolonën e parë e shkruan *Di*, në kolonën e dytë *Dua të di*, dhe në kolonën e fundit *Mësova*. Në kolonën e parë shënojnë çdo gjë që mendojnë se dinë për *Kthimin e Skënderbeut në Krujë*, ndërsa në kolonën e dytë çdo gjë që dëshirojnë të dinë rreth kësaj ngjarjeje. Ndërsa në kolonën e tretë, shkruhen të gjitha informacionet e reja që marrin.

Pasi të përfundojnë diskutojnë në grup për të shkëmbyer idetë mes tyre, pas pesë minutave përmbledhjen e ideve e prezantojnë për tërë klasën. Mësimdhënësi/ja shënon të gjitha mendimet e nxënësve në **tabelë**.

Di	Dua të di	Mësova

Pjesa përfundimtare:

Pasi të kenë përfunduar diskutimet në grup, kërkohet nga mësimdhënësi/ja dhe nxënësit të reflektojnë dhe të shkëmbejnë informacionet e reja që dalin gjatë leximit. Ndërkohë mësimdhënësi shpjegon dhe sqaron konceptet kryesore të mësimi: Të gjitha idetë e nxënësve shënohen në tabelë, dhe njëkohësisht bëhen pyetje të ndryshme për të vërtetuar se a ishin plotësuar njohuritë e nxënësve nga teksti që kishin lexuar.

Duke marrë informacionet, mësimdhënësi si detyrë shtëpie mund të kërkojë nga nxënësit të bëjnë punë hulumtuese në internet për *Rrethimin e Krujës*.

Aktivitete shitesë:

Diskutoni dhe planifikoni me grupin dhe klasën për të organizuar një ekskursion mësimor në Lezhë, që të njiheni për së afërmi me Lezhën.

Vlerësimi:

Vlerësim i vazhdueshëm

Vlerësim individual

Nxënësit vlerësohen për angazhim në grup

Nxënësit vlerësohen për interesimin e tyre në ekskursion

43. LUFTËRAT E SHQIPTARËVE NËN UDHËHEQJEN E SKENDERBEUT

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.
1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH: Kompetenca I 6. II 2; 5. V 1.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon veçoritë kryesore të personalitetit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut si strateg dhe burrë shteti.
- Dallon betejat kryesore të luftës mbrojtëse kundër pushtimit osman dhe prezanton argumente për jehonën e luftës së Skënderbeut në Evropë dhe më gjerë.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Fitore, udhëheqje, konflikt, rrethim

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, histori ushtarake

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja në këtë fazë të orës përdor teknikën *Parashikim me terma paraprakë*. Mësimdhënësi/ja ndan tabelën në dy kolona, në secilën kolonë shkruan nga disa terma: Kolona 1- *Ali Pasha, Sulltan Murati, Shqipëri, Dibra*; ndërsa në kolonën e 2- *Venediku, Kruja, Konflikti, Rrethimi, Ushtria Osmane*. Klasa ndahet në dy grupe të mëdha. Mësimdhënësi/ja i udhëzon grupet që nga termat e kolonave të tyre të krijojnë një histori të shkurtër. Pasi të përfundojnë, nxënësit vullnetarisht lexojnë krijimet e tyre.

Pjesa kryesore:

Në vazhdim mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin në mënyrë individuale duke vendos shenjat: Shenja $\sqrt{}$ (tik) informacion i cili njihet nga nxënësit, shenja – (minus) informacion i cili është i ndryshëm nga informacioni që kanë pasur më parë,

shenja + (plus) informacion i ri dhe shenja ? (pikëpyetje) informacion i paqartë për nxënësin. Gjatë kohës që lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas plotësojnë tabelën sipas udhëzimeve të mësimdhënësit.

√	-	+	?

Pjesa përfundimtare:

Në vijim nxënësit/et lexojnë disa nga punimet e tyre, ndërsa mësimdhënësi/ja plotëson tabelën sipas reflektimit të nxënësve. Ndërkohë mësimdhënësi/ja shpjegon dhe sqaron informacionet e paqarta që kanë paraqitur nxënësit.

Aktivite shtesë:

Nxënësit në mënyrë individuale vizatojnë *Rrethimin e Krujës*, në krye me Skënderbeun. Pasi të vizatojnë, ata prezantojnë në klasë punimet e tyre dhe mandej ekspozojnë në muret e klasës.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen sipas bashkëpunimit në grup

Në punë individuale

Sipas prezantimit të punës së tyre.

44. MARRËVESHJA E SKENDERBEUT ME ALFONSIN V TË NAPOLIT DHE VAZHDIMI I LUFTËRAVE PËR MBROJTJEN E SHTETIT SHQIPTAR

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme

RNSH:Kompetenca I 3. II 2. III 3. V 8.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon veçoritë kryesore të personalitetit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut si strateg dhe burrë shteti.
- Dallon betejat kryesore të luftës mbrojtëse kundër pushtimit osman dhe prezanton argumente për jehonën e luftës së Skënderbeut në Evropë dhe më gjerë.
- Identifikon shtresat shoqërore, marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe evidenton të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Aleancë, rrethim, betejë

Burimet: Libri, interneti, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja e fillon bashkëbisedimin me nxënësit në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve me nxënësit siç janë: *Cilat ishin arsyet e aleancës së Skënderbeut me Mbretërinë e Napolit? Vlerësoni Fitolet e Skënderbeut përballë ushtarëve osmanë. Analizoni arsyet e tradhtisë ndaj Skënderbeut të Moisi Golemit dhe Hamza Kastriotit etj.* Nxënësit shkruajnë lirshëm, pa u kufizuar në mendime kufizime, pastaj bashkë bisedojnë në çifte, grupe, e më vonë prezantojnë para klasës.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të zhvillimit të orës mësimore, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ta janë më interesante dhe më të rëndësishme. Pjesa e përzgjedhur dhe numri i faqes shënohen në një fletëz, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për pjesën e përzgjedhur të njësisë. P.sh.(Pse e kanë përzgjedhur njësinë që flitet për Betejën e Modriçës cili është mesazhi, rëndësia etj.). Njëri nga nxënësit e tregon faqen se ku e ka zgjedhur pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit, të tjerët diskutojnë rreth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentin e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komenti, nxënësit e tjerë nuk kanë të drejtë të japin komente shtesë. E njëjta ecure e leximit të citatit dhe komentimit praktikohet edhe te nxënësit e tjerë.

Pjesa përfundimtare:

Gjatë kësaj faze të orës, nxënësit udhëzohen të bashkohen në dyshe. Njëri nga anëtarët e çiftit ka për detyrë të shkruajë për pesë minuta për një temë. P.sh. (shkruani një rast që keni bërë bashkëpunim me një shoqe apo shok për ndonjë projekt, apo për ndonjë aktivitete tjetër. Shkrimi të bëhet në mënyrë individuale. Më pastaj lexojnë në mënyrë vullnetare, formulojnë pyetje për shokun/shoqen në dyshe e më pastaj në grup. Pasi të përfundojnë mund të ketë edhe diskutime

Aktivitete shtesë:

Në klasë debatojnë për temën.
Përzgjidhet një nxënës/e që do ta udhëheqë debatin.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për komunikim
Në përgjigjet, idetë dhe sugjerimet që japin në pyetjet e parashtruara për njëri-tjetrin.
Në aktivitete gjatë orës mësimore.

45 FITORJA E UJIT TË BARDHË, VAZHDIMI I LUFTËRAVE TË SKENDERBEUT DHE RRETHIMI I DYTË I KRUIJËS

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme

RNSH:Kompetenca I 2; 4. IV 3; 6. V 1; 6.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon veçoritë kryesore të personalitetit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut si strateg dhe burrë shteti.
- Dallon betejat kryesore të luftës mbrojtëse kundër pushtimit osman dhe prezanton argumente për jehonën e luftës së Skënderbeut në Evropë dhe më gjerë.
- Identifikon shtresat shoqërore, marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe evidenton të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Ujëbardhi, betejë, provokim, përforcim.

Burimet: Libri, interneti, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, teknologji

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Pjesa hyrëse e orës mësimore zhvillohet përmes teknikës *Stuhi mendimesh*. Mësimdhënësi/ja parashtron disa pyetje rreth njohurive paraprake që mund të kenë nxënësit rreth temës që do të zhvillohet gjatë orës mësimore, p.sh.: *Çka dini për Ujëbardhin (Albulenën)? A keni dëgjuar për Mehmetin e II Fatihu? A keni njohuri se pse konsiderohet i turpëruar Fatihu në rrethimin e dytë të Krujës?* Mësimdhënësi/ja shënon të gjitha mendimet e nxënësve në tabelë, për të treguar respekt ndaj nxënësve, për të treguar se janë të vlerësuar, për të krijuar vetëbesim te nxënësit, për të qenë përgjegjës për fjalën e thënë, për të motivuar dhe inkurajuar për mësim, bashkëpunim dhe komunikim.

Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja në fillim ndan nxësinë mësimore në katër pjesë (paragrafë). Gjithashtu i ndan nxënësit në katër grupe familjare, të cilat caktohen me numra nga 1 deri në 4. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, me numrin dy në një grup tjetër, treshet me treshë, e kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja. Të gjithë këta nxënës të caktuar në grupet e tyre në bashkëpunim mësojnë nxësinë sa më mirë që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'u shpjegojnë nxënësve të tjerë pjesëzën e mësuar. Për të kuptuar sa më mirë pjesën e njësishë mësimore, nxënësit parashetrojnë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon deri sa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Pasi të përfundojnë realizimin e orës mësimore, nxënësit për reflektim udhëzohen të shkruajnë një përmbledhje të shkurtë për atë se çfarë kanë mësuar, një ese reflektuese (në mënyrë individuale). Më pas, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të reflektojnë para tërë klasës duke lexuar esetë reflektuese, gjithnjë duke pasur kujdes që nxënësit të marrin përgjegjësinë për mësimnxënie të pavarur.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit/et ndahen në katër grupe. Secili grup emëron një udhëheqës/e të grupit. Udhëheqësi/ja i/e grupit i përcakton grupit detyra, sipas përzgjedhjes së tyre: p.sh.:

Grupi 1 shkruan për *Rrethimin e dytë të Krujës*,

Grupi 2. Shkruan për *Rrethimin e tretë të Krujës*

Grupi 3. Shkruan për *Fitoren e Ujit të Bardhë*

Grupi 4. Shkruan për *Betejën e Vitit 1462 në Mokër dhe Pollog*.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësve në aktivitete të ndryshme;

Vlerësim i nxënësve në përgjegjësinë individuale dhe shoqërore që shfaqin.

Vlerësim formativ.

46. GJERGJ KASTRIOTI-SKENDERBEU SIMBOL I FORMIMIT TË KOMBIT SHQIPTAR DHE MBROJTËS I CIVILIZIMIT EVROPIAN

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH:Kompetenca II 2; 3. II 1; 6. III 5.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Shpjegon veçoritë kryesore të personalitetit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut si strateg dhe burrë shteti.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Flamur, simbol, shtet, civilizim

Burimet: Libri, internet, harta gjeografike, harta historike, foto

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Arkeologji, gjeografi, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në pjesën hyrëse mësimdhënësi/ja bën një *brainstorming* në çift me pyetjet:1) Për çfarë arsye Skënderbeu quhet simbol i formimit të kombit 2) Pse quhet Skënderbeu mbrojtës i civilizimit evropian? 3.) Në cilat vende të botës ekzistojnë buste të Skënderbeut? etj. Nxënësit përgjigjen lirshëm pa iu kufizuar mundësia për përgjigje. Disa përgjigje të nxënësve shkruhen në dërrasë të zezë.

Pjesa kryesore:

Në vijim mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit/et në mënyrë individuale do të lexojnë tekstin me titull: *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, simbol i formimit të kombit shqiptar dhe mbrojtës i civilizimit evropian*. Gjatë leximit, nxënësit vendosin nga një shenjë si më poshtë:

Shenja √ (tik) informacion i cili njihet nga nxënësit,

Shenja – (minus) informacion i cili është i ndryshëm apo kundërshton idenë apo informacionin e mëparshëm të nxënësit.

Shenja + (plus) informacion i ri dhe shenja ? (pikëpyetje) informacion i paqartë për nxënësin.

Gjatë kohës që lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas plotësojnë tabelën sipas

udhëzimeve:

√	-	+	?

Në vijim lexohen disa nga punimet e nxënësve. Nxënësit diskutojnë së bashku me mësimdhënësin/en për sqarimin e ideve dhe koncepteve të paqarta.

Pjesa përfundimtare:

Në fazën përmbyllëse, nxënësve u kërkohet të zgjedhin një nga çështjet e mëposhtme dhe të japin mendimet, idetë dhe njohuritë që mësuan rreth tyre. Kjo realizohet me ditarin dypjesësh.

Çështja	Komenti
Analizoni disa thënie të huaja të thëna për Skënderbeun	

Aktivitete shitesë:

Nxënësit të ndahen në grupe, me nga katër anëtarë.

Nga secili grup kërkohet që të zhvillojë aktivitete të ndryshme për temën *Skënderbeu*.

Grupi 1. udhëzohet të pikturojë figurën e Skënderbeut,

Grupi 2. të hulumtojë për shkrimtarët të cilët kanë shkruar për Skënderbeun

Grupi 3. të hulumtojë për filmat që janë shfaqur për figurën e Skënderbeut.

Grupi 4. të shkruajë një ese me temën: Skënderbeu

Nxënësit prezantojnë me radhë aktivitetet e tyre.

Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për aktivitete dhe bashkëpunim në grup

Nxënësit/et vlerësohen për performancën e tyre gjatë prezantimit të grupit

Nxënësit/et vlerësohen për përdorimin e medieve për nevoja mësimore.

47. KANUNET SHQIPTARE NË MESJETË

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.

3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.

RNSH:Kompetenca I 1. II 2. IV 3; 4. V 8. VI 2.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Ilustron aspekte të jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare.
- Shpjegon rolin e kanuneve shqiptare dhe ndikimin e tyre në shoqërinë mesjetare arbërore/shqiptare.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Kanun, rregulla, zakon, përmbajtje

Burimet: Libri, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: gjeografi, ed.qytetare, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja në këtë fazë të orës mësimore, së pari e ndan klasën në grupe prej 6 nxënësish dhe u kërkon atyre të plotësojnë një kllaster me fjalitë *Kanunet shqiptare në Mesjetë*. Pas 5-10 minutash, një nxënës lexon punën e grupit. Mendimet e nxënësve mund të shkruhen në tabelë duke bërë një kllaster i cili mund të plotësohet me ide të reja nga grupi vijues. Nga nxënësit kërkohet që fjalët apo fjalitë e treguara nga grupi paraprak të mos përsëriten për shkak të kohës së kufizuar.


Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës, mësimpldhënsi/ja në bashkëpunim me nxënësit përdorin teknikën *Di, dua të di, mësova*. Në kolonën e dytë rreshtohen pyetjet për të cilat nxënësit/et duan të dinë më shumë. Kur nxënësit/et nuk japin më përgjigje nga pyetjet e bëra, atëherë kërkohet që të hapin tekstin dhe t'i gjejnë përgjigjet nga pyetjet që i kanë bërë.

Di	Dua të Di	Mësova

Pjesa përfundimtare:

Mësimpldhënsi/ja përmes teknikës së rrjetit të diskutimit, diskuton me nxënësit: A mendoni se edhe sot ka njerëz që veprojnë sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit? Nxënësit/et deklarohen me po ose jo, por mund të mos deklarohen fare. Ata ndahen në tri grupe me argumentet e tyre PO ose JO dhe që nuk deklarohen.



Mësimpldhënsi/ja duhet të respektojë idetë dhe angazhimet e nxënësve, sepse pa këtë nxënësit nuk do të jenë të lirë të mendojnë në mënyrë kritike. Po ashtu analiza kritike e opinionëve është me vlerë dhe kjo duhet të bëhet përmes ndërveprimit dhe me diskutime. Nxënësi/ja duhet të bindet se opinionet e tyre janë me vlerë. Po ashtu, mësimpldhënsi/ja duhet të angazhohet maksimalisht që të bëjë përfshirjen aktive të të gjithë nxënësve në diskutime.

Aktivitete shitesë:

Nxënësist sjellin në klasë Kanunin, dhe ndonjëri prej nxënësve lexon me zë ndonjë paragraf të Kanunit, dhe nxënësist/et analizojnë dhe më pastaj diskutojnë.

Vlerësimi:

Nxënësist/et vlerësohen për bashkëpunim në grup

Nxënësist vlerësohen për punë individuale

Nxënësist vlerësohen në pjesëmarrje në diskutim

48. KULTURA NË ARBËRI NE SHEKUJT XIII-XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH:Kompetenca I ;2; 4; 6. IV 3; 4; 5.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon personalitetet më të spikatura nga fusha e artit, kulturës, shkencës, teknologjisë e politikës në Mesjetë, dhe vlerëson veprimtarinë e kontributin e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Arsimit, krijimtari, letërsi, dokument, arkitekturë

Burimet: Libri, interneti, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjeografi, letërsi, arkeologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në fillim të orës mësimore, mësimdhënësi/ja fillon diskutimin me nxënës/e në formë të bashkëbisedimit, përmes pyetjeve dhe përgjigjeve. Përgjigjet mund të jenë individuale, më pas bashkim i ideve në çifte e në grupe. Por përgjigjet mund të mirren edhe në mënyrë frontale (kur problemi paraqitet para gjithë klasës). Pyetjet që parashtrohen mund të jenë: *Çfarë mendoni, në shek. XIII-XV, cilët njerëz shkolloheshin më së shumti, dhe pse?, Çka quajmë krijimtari gojore? A keni dëgjuar për Muja e Halilin dhe Gjergj Elez Alinë? Cili është dokumenti i parë në gjuhën shqipe?* Nxënësit nuk duhen të kufizohen në dhënien e përgjigjeve. Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë (dërrasë të zezë) .

Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja në fillim e ndan njësinë mësimore në katër pjesë, apo paragrafë. Pastaj i ndan nxënësit në katër grupe dhe u jep udhëzime se si të punohet. Njësia ndahet në katër pjesë: 1) Arsimit dhe Letërsia e shkruar, 2) Krijimtaria gojore, 3.) Cili është dokumenti i parë i gjuhës shqipe i gjetur deri më sot, 4) Arkitektura, skulptura dhe piktura në Arbëri. Të gjithë anëtarët e grupit lexojnë pjesën e parë. Një anëtar i grupit luan rolin e mësuesit. Puna e tij ka tri role: 1.)Shpjegon kuptimin e pjesës së lexuar, 2) Jep përgjigje, sqarime në pyetjet e anëtarëve të grupit dhe 3.)Bën pyetje për anëtarët e tjerë të grupit. Për të gjitha pjesët e leximit përcaktohet nga një nxënës për

të luajtur rolin e mësimehënës/et. Ecuria vazhdon njëjtë për të gjitha pjesët e njësise. Nxënësit sipas radhës marrin pjesë në shpjegimin e njësise.

Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimehënës/ia kërkon nga nxënësit që të marrin nga një fletë dhe të shkruajnë temën: *Gjendja e arsimit sot*. Pastaj, kur grupet të shkruajnë në fletën e vet, fletat përcillen nga njëri grup te tjetri, derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për këtë temë, apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Aktivite shtesë:

Nxënësit/et hulumtojnë në internet dhe diskutojnë për rëndësinë e dokumenteve të para të shkruara të gjuhës shqipe.

Nxënësit hulumtojnë në internet për arkitekturë, skulptura dhe piktura të Shqipërisë dhe Kosovës, më pastaj të gjitha punimet e tyre vendosën në muret e klasës. Nxënësit pastaj lëvizin duke i shikuar dhe krahasuar punimet me radhë.

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen për bashkëpunim në grup

Vlerësim në paraqitjen e ideve

Vlerësimi në komunikim.

49. PERSONALITETE SHQIPTARE TË SHEKULLIT XV

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.	RNSH: Kompetenca I 2; 4; 6. III 1; 2.
---	--

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon personalitetet më të spikatura nga fusha e artit, kulturës, shkencës, teknologjisë e politikës në Mesjetë, dhe vlerëson veprimtarinë e kontributin e tyre.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Personalitete, Gjergj Kastrioti, Donika, Mamica, Vrana Konti, Moisi Golemi

Burimet: Libri, foto, interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Teknologji, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja fillimisht nxënësve u bën pyetje nxitëse dhe orientuese për atë se çfarë do të mësohet në vijim të orës mësimore. Pyetjet mund të jenë: *Çfarë dini për familjen e Gjergj Kastriotit? Sa fëmijë ishin? Si e pagëzoi Sulltani Gjergj Kastriotin, pasi që e mori peng? Cilën gradë ia kishte dhënë Sulltani Skënderbeut? Keni dëgjuar për Moisi Golemin dhe për Vrana Kontin?* etj. Të gjitha përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.

Pjesa kryesore:

Në vijim nxënësit ndahen në grupe. Përbërja e numrit të anëtareve të një grupi varet prej numrit të nxënësve që ka klasa. Mësimdhënësi/ja njësinë mësimore e ndan në pesë paragrafë, si: *Gjergj Kastrioti, Donika Kastrioti, Mamica Kastrioti, Vrana Konti dhe Moisi Golemi*. Në vijim, kërkohet nga nxënësit të lexojnë në mënyrë individuale njësinë e ndarë në këto paragrafë. Pas leximit të paragrafit të parë, nxënësit bashkëbisedojnë në çifte, e më pas me tërë klasën, duke reflektuar për atë se çfarë kanë nxënë.

Pasi të reflektojnë mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit mund të parashtrojnë pyetje shtesë rreth pjesës së lexuar. Në këtë mënyrë zhvillohen të gjithë paragrafët e njësive mësimore.

Pjesa përfundimtare:

Në fund të orës mësimore mësimdhënësi/ja kërkon nga grupet që: Njëri grup të shkruan një ese për Gjergj Kastriotin, grupi tjetër të pikturojë Mamica Kastriotin dhe Donika Kastriotin, grupi tjetër të hulumtojë për Moisi Golemin dhe Vrana Kontin .Më pastaj fillojnë diskutimet me tërë klasën dhe punimet e tyre, sidomos pikturat, vendosen në muret e klasës.

Aktivitete shitesë:

Nga pesë grupe të klasës kërkohet të hulumtojnë në internet për personalitetet që i kanë mësuar gjatë orës mësimore. Secili grup e prezanton para klasës përmes power-pontit hulumtimin që ka realizuar. Nxënësit e tjerë marrin shënime dhe njëkohësisht inkuadrohen përmes pyetjeve dhe përgjigjeve në diskutime që zhvillohen me tërë klasën.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për punë individuale dhe grupore
Vlerësimi i nxënësve bëhet për shkathtësitë e tyre krijuese dhe hulumtuese
Vlerësimi i nxënësve bëhet për cilësinë e prezantimeve.

VIII. HUMANIZMI DHE RILINDJA EVROPIANE

50. HUMANIZMI DHE RILINDJA NË EVROPË

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
---	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.

RNSH: Kompetenca I 2; 4. II 8. III 1; 6.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Analizon rolin e kishës në shoqërinë mesjetare, identifikon disa nga urdhërat kryesorë fetarë dhe përshkruan inkuizicionin si mënyrë e luftimit të oponencës ndaj saj.
- Debaton për *Skizmën e madhe të Perëndimit* dhe identifikon lëvizjet e para për reformimin e kishës.
- Analizon rrethanat kulturore, ekonomike dhe politike në Evropë në prag dhe gjatë periudhës së Humanizmit dhe Renesancës.
- Numëron disa nga humanistët evropianë dhe vlerëson ndikimin e tyre në shoqërinë mesjetare.
- Vlerëson kontributin shkencor, kulturor, artistik të figurave përfaqësuese të renesancës dhe evidenton ndikimin e tyre në shoqëri.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë

Fjalë kyçe: Humanizëm, rilindje, letërsi, gjuhë, pikturë, arkeologji

Burimet: Libri, foto, harta gjeografike, harta historike

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Për këtë njësi mësimore mund të përdoret *Di / Dua të di / Mësoj*, si teknikë e vetme e cila përmban në vete të tri fazat e orës mësimore. Në fillim të orës, mësimdhënësi i njofton nxënësit për temën që do ta zhvillojnë dhe i udhëzon që në mënyrë individuale të formojnë një tabelë në fletoret e tyre. Mësimdhënësi/ja vizaton në tabelë tri kolona, si në vijim:

Di	Dua të di	Mësova

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë nxënësit do të lexojnë në mënyrë individuale njësinë mësimore, duke qenë të kujdesshëm dhe të mbajnë shënime për të plotësuar tabelën rreth informatave që marrin gjatë leximit. Pasi të kenë përfunduar do të bashkëbisedojnë në grup për të reflektuar për informacionet e ndryshme që kanë hasur në tekst. Në kolonën e parë shënojnë çdo gjë që mendojnë se dinë për humanizmin dhe personalitetet e shquara të asaj kohe, si dhe, për rolin pengues të kishës në kohën e Humanizmit dhe Renesancës. Në kolonën e dytë shënohet çdo gjë që dëshirojnë të dinë rreth njësisë mësimore, dhe në kolonën e tretë shënojnë atë se çfarë kanë mësuar.

Pasi të përfundojnë do të diskutojnë në grup për të shkëmbyer idetë mes tyre, pas pesë minutave përmbledhjen e ideve do ta prezantojnë për tërë klasën. Mësimdhënësi do të shënojë të gjitha mendimet e nxënësve në tabelë.

Pjesa përfundimtare:

Pasi të kenë përfunduar diskutimet në grup, kërkohet nga mësimdhënësi/ja dhe nxënësit të reflektojnë dhe të shkëmbejnë informacionet e reja që dalin gjatë leximit. Ndërkohë mësimdhënësi/ja shpjegon dhe sqaron konceptet kryesore të mësimi: Të gjitha idetë e nxënësve shënohen në tabelë, dhe njëkohësisht shtrohen pyetje të ndryshme për të vërtetuar se a ishin plotësuar njohuritë e nxënësve nga teksti që kishin lexuar.

Duke marrë informacionet, mësimdhënësi si detyrë shtëpie mund të kërkojë nga nxënësit të bëjnë punë hulumtuese në internet për personalitetet e periudhës së Humanizmit dhe Renesancës.

Aktivitete shitesë:

Nxënësit/et hulumtojnë në internet për veprat e humanistëve të njohur.

Po ashtu nxënësit hulumtojnë në internet për arritjet e Kopernikut, Xhordano Brunos dhe Galile-Galileut.

Vlerësimi :

Nxënësit/et vlerësohen për punë individuale dhe grupe

Nxënësit vlerësohen për aftësi hulumtuese

Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimeve.

51. HUMANISTËT SHQIPTARË

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Histori	Shkalla e kurrikulës: Shkalla 3	Klasa: 7
--	--------------------------	---	--------------------

RNF: 1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.

RNSH:Kompetenca I 2; 4. II 8. III 1;6.

Rezultatet e të nxënës të lëndës:

Nxënësi/ja:

- Identifikon personalitetet më të spikatura nga fusha e artit, kulturës, shkencës, teknologjisë e politikës, në Mesjetë, dhe vlerëson veprimtarinë e kontributin e tyre.
- Numëron disa nga humanistët shqiptarë dhe vlerëson kontributin e tyre në kulturën arbërore/shqiptare dhe evropiane.

Kriteri i suksesit: Kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Fjalë kyçe: Humanist, Gjini Gjon Gazuli, Marin Barleti, Andrea Durrësaku, Marin Biçikemi, Dhimitër Frangu, Onufri.

Burimet: Libri, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Letërsi, art.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Pjesa hyrëse:

Në fillim të orës mësimore, mësimsdhënësi/ja përmes integritit të TIK-ut (programit power point) paraqet të gjitha fotografitë e humanistëve shqiptarë, duke i bërë pyetje nxënësve, se a kanë njohuri se kush janë. Nxënësit japin mendime të ndryshme. Ata nuk duhet të kufizohen në dhënien e përgjigjeve. Në vazhdim, mësimsdhënësi/ja tregon emrat e figurave të humanistëve të cilët i ka paraqitur përmes sllajdeve.

Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësve u kërkohet që të zgjedhin nga një partner për çift, ngase e gjithë puna do të bëhet në bashkëpunim të çifteve. Duke i numëruar çiftet (1,2,3,4,5,6.) secili çift në klasë i caktohet numri 1 deri 6. Kjo bëhet nga se njësia është e ndarë në 6 paragrafë, që përshkruhen gjashtë figura të humanistëve shqiptarë. Si: Gjini Gjon Gazuli, Marin Barleti, Andrea Durrsaku, Marin Biçikemi, Dhimitër Frangu dhe Onufri. Çiftet informohen se leximi do të jetë i veçantë. Atyre u jepen këto udhëzime : 1.) Dy anëtarët e çiftit do të lexojnë në mënyrë individuale gjithë tekstin që iu është dhënë. Secili çift lexon në mënyrë individuale për një figurë të humanizmit, p. sh.: Çifti (A, B) lexojnë : A lexon për Gjini Gazulin, ndërsa B lexon për Marin Barletin. Pas leximit, pjesën e parë të tekstit (për Gjini Gazulin) ka për detyrë ta

shpjegojë nxënësi A i çiftit, ndërsa nxënësi tjetër (B) i bën pyetje A-së për të njëjtën pjesë. Në pjesën e dytë të tekstit, për (Marin Barletin) ndërrohen rolet. Nxënësi (B) bën shpjegimin e pjesës së vet, ndërsa nxënësi A bën pyetje. Ecuria e punës vazhdon kështu për të gjitha grupet. Meqenëse numri i lexuesve dhe raportuesve është i madh, atëherë kërkohet që leximi dhe raportimi të jetë me zë të ulët. Pra, mësimi zhvillohet: Lexim, raportim, pyetje dhe përgjigje. Më pas çiftet do të paraqesin në letër transparente (në flipçart) punën e tyre, dhe nga një çift nga secila pjesë do të prezantojnë para klasës njësinë që e kanë përfunduar.

Pjesa përfundimtare:

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë (dërrasë të zezë) emrin e temës, apo një emër që ka të bëjë me këtë temë. Meqenëse në këtë njësi kemi të bëjmë me gjashtë personalitete të humanizmit shqiptar, siç janë: Gjon Gjin Gazulli, Marin Barleti, Andrea Durrsaku, Marin Biçikemi, Dhimitër Frangu si dhe Onufri, mësimdhënësi/ja kërkon nga të gjitha çiftet që kanë lexuar për ndonjërin prej këtyre figurave të krijojnë një pesëvargësh. Secili nxënës punon në mënyrë individuale. Së pari shënohet emri i njëres prej këtyre figurave. Nën emër shënojmë dy mbiemra, vazhdojmë me tri folje, një fjali përfundimtare dhe me sinonimin e fjalisë. Për të gjitha figurat e humanizmit veprohet në këtë mënyrë.

Gjin Gjon Gazuli

2. dy mbiemra _____
3. tri folje _____
4. një fjali _____
5. Sinonimi _____

Aktivitate shitesë:

Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen që të përzgjedhin ndonjë personalitet të shquar të humanizmit shqiptar për të vizatuar. Pasi që të vizatojnë, vizatimet e nxënësve mund të bëhen poster dhe mandej të ekspozohen në klasë.

Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për punën individuale, në çift dhe në grup
Nxënësit/et vlerësohen për integrimin e artit dhe TIK-ut në proces të nxënies. Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimeve